


STUDIMI PËR RININË - KOSOVË 2018/2019



FONDACIONI "FRIEDRICH EBERT"

Fondacioni "Friedrich Ebert" (FES) është fondacioni politik më i vjetër në Gjermani me një traditë të pasur të social-demokracisë, e cila daton prej 1925-ës. Angazhimi i fondacionit tonë politik, përqëndrohet në idetë bazë dhe vlerat e social-demokracisë, lirisë, drejtësisë dhe solidaritetit. Kjo na lidh ne me social-demokracinë dhe lëvizjen e lirë sindikaliste.

Nëpërmjet rrjetit tonë ndërkombëtar të zyrave në më shumë se 100 shtete, FES mbështet politikën e bashkëpunimit paqësor dhe të drejtat e njeriut, promovimin, zbatimin dhe konsolidimin e demokracisë, strukturave sociale dhe kushtetuese, si dhe na bën pionierë në forcimin e sindikatave të lira dhe të një shoqërie civile të fortë. Ne jemi të përfshirë në mënyrë aktive në promovimin e një Evrope sociale, demokratike dhe konkurruese në kuadër të procesit të Integritimit Evropian.

STUDIMET RINORE NË EVROPËN JUG-LINODRE 2018/2019:

"Studimet Rinore të FES për Evropën Jug-Lindore 2018/2019" është një projekt ndërkombëtar kërkimor i kryer njëkohësisht në dhjetë shtete të Evropës Jug-Lindore, specifikisht në: Shqipëri, Bosnjë – Herzegovinë, Bullgari, Kroaci, Kosovë, Maqedoni, Mali Zi, Rumani, Serbi dhe Slloveni. Objektivi kryesor i studimit është të identifikojë, përshkruajë dhe analizojë qëndrimet dhe modelet e sjelljes në shoqëritë moderne.

Të dhënat janë mbledhur në fillimin të vitit 2018 dhe më shumë se 10.000 të rinj të moshës 14-29 vjeç nga vëndet e sipërpërmendura të dhjetë shteteve të Evropës Jug-Lindore, morën pjesë në këtë analizë. Studimet mbulojnë një sferë të gjërë të çështjeve, përsa i përket eksperiencave dhe aspiratave të tyre në fusha të ndryshme të jetës siç janë; edukimi, punësimi, përfshirja politike, marrëdhëniet familjare, koha e lirë dhe përdorimi i teknologjive të informacionit dhe komunikimit, por gjithashtu të vlerave, qëndrimeve dhe besimeve.

Kërkimi empirik prezantohet nëpërmjet dhjetë studimeve kombëtare dhe një studimi rajonal të publikuar në gjuhën Anlgeze dhe ato vëndase.

STUDIMI PËR RININË – KOSOVË 2018/2019

Oltion Rumbullaku
IDRA Research & Consulting



| | | |
|-----------|---|-----------|
| 1 | Hyrje | 3 |
| 2 | Përmbledhje ekzekutive | 5 |
| 3 | Metodologjia | 9 |
| 4 | Vlerat, feja dhe besimi | 13 |
| 5 | Mënyra e jetesës dhe koha e lirë | 21 |
| 6 | Familja dhe shoqëria | 29 |
| 7 | Arsimimi | 37 |
| 8 | Punësimi | 43 |
| 9 | Demokracia dhe qeverisja | 51 |
| 10 | Aspiratat për të migruar | 65 |
| 11 | Identiteti kosovar, BE dhe vendet fqinje | 73 |
| 12 | Përfundime | 81 |
| | Shënime në fund të faqes | 82 |
| | Referencat | 82 |
| | Diagramet | 83 |
| | Tabelat | 84 |

1

HYRJJE

Qëllimi kryesor i këtij studimi është të vlerësojë, përshkruajë dhe shpjegojë qëndrimet, besimet dhe vlerat e të rinjve kosovarë në nivel të: shoqërisë, ekonomisë, arsimit dhe punësimit, integritit në Bashkimin Evropian, fesë, familjes, jetës sociale dhe preferencat e mënyrës së jetesës.

Besohet se brezi i ri i këtij grupi (individë të lindur në vitet 1989–2004), konsideruar si Gjenerata Z apo post-mijvjeçarët kanë vlera, karakteristika dhe preferenca shumë të veçanta dhe unike, pasi këta të rinj kanë qenë dëshmitarë të transformimeve sociale dhe ekonomike në të kaluarën e afërt dhe kanë përdorur internetin që në moshë të re dhe në përgjithësi janë përshtatur me teknologjinë dhe ndërveprimin në mediat sociale.

Ashtu si shumë vende të Ballkanit Perëndimor, Kosova është ende në tranzicion. Kosova po përpiket të gjejë rrugën e saj midis Evropës dhe të se kaluarës, dhe vlerat, modelet e integritit dhe faktorët e sigurisë që lidhen me të.

Rruga e gjatë e ndërtimit të një vendi të ri me një shoqëri demokratike dhe ekonomi të tregut të lirë është ende larg. Marrëdhëniet e ndërlikuara me Serbinë ende mbeten sfidë për vendin, pas që e ka izoluar si dhe ka shkaktuar vështirësi në procesin e integritit në Bashkimin Evropian.

Ky studim pasqyron brengat, aspiratat, vlerat dhe mënyrën e jetesës së rinisë kosovare. Të rinjtë, që sot janë në moshën 14 deri 29 vjeç janë rritur pas ndarjes së Kosovës nga Serbia, në një Kosovë të pavarur, kështu që mund t'i quajmë “brezi i pavarësisë”. Ky brez është një mjet i rëndësishëm për zhvillimin e Kosovës në të ardhmen.

Në veçanti, të rinjtë nga vendet e ish-Jugosllavisë, dhe më konkretisht, kosovarët kanë përjetuar ngjarje dramatike dhe tronditëse: luftën, rënien e shtetit federal dhe ndarjen në shtete të vogla të pavarura, kalimin nga komunizmi në kapitalizëm, procesin e gjatë të tranzicionit, privatizimin e pronësisë shoqërore, refuzimin e liberalizimit të vizave, ndryshimin e monedhës, nivele të larta të papunësisë dhe varfërisë, nivele të larta migrimi, etj. Nga ana tjetër, ata ishin dëshmitarë të një epoke të re inovacioni në kompjuterë, celularë dhe internet, që ishte një lloj revolucioni dhe fillimi i një mënyre të re jetese, moderne, si tipare të shekullit XXI.

Ky studim bazohet në një sondazh përfaqësues të të gjithë vendit, i cili u zhvillua nga dhjetori 2017 deri në janar 2018 në Kosovë, me të rinj të moshave nga 14 deri 29 vjeç. Ky studim është bazuar në modelin e Studimit Rinor të Shell, i cili është kryer në mënyrë periodike në Gjermani që nga viti 1953 dhe ka rezultuar të jetë një tregues i vlefshëm i zhvillimit afatmesëm të shoqërisë. Fondacioni Friedrich Ebert ka kryer një sërë studimesh të ngjashme në vendet e Ballkanit Perëndimor, dhe një studim të mëparshëm në Kosovë në vitin 2012.

Shumica e të rinjve jetojnë me familjet e tyre, kryesisht për arsye praktike apo thjesht pasi që kjo është mënyra tradicionale e jetesës. Të rinjtë dëshirojnë që të martohen në moshën 26–28 vjeçare dhe në përgjithësi duan të kenë tre fëmijë. Ka një pjesëmarrje të ulët në aktivitete vullnetare dhe një nivel të lartë të homofobisë, që tregon një shkallë të ulët diversiteti.

2

PËRMBLEDHJE

EKZEKUTIVE

Duke përdorur një kombinim metodash sasiore dhe cilësore, Studimi Rinia e Kosovës 2018 zbulon qëndrimet, mendimet dhe pritshmëritë e të rinjve në vend. Gjetjet paraqesin jetën e përditshme të të rinjve në Kosovë në kontekstin e vlerave familjare, mospërputhjet e arsimit dhe punësimit në realitet, si dhe kontekstin tradicional kulturor dhe kombëtar.

Ky studim ka për qëllim të paraqesë çështjet kryesore të të rinjve kosovarë lidhur me mënyrën e jetesës në familje, pjesëmarrjen politike, arsimimin, punësimin, lëvizshmërinë dhe marrëdhëniet me vendet fqinje.

Të rinjtë në Kosovë në përgjithësi janë tradicionalë. Studimi ynë tregon se janë shumë të varur nga prindërit – kryesisht moralisht dhe materialisht – dhe preferojnë që në të ardhmen të jenë pjesë e familjeve të mëdha. Ky brez i ri ka një grup të veçantë vlerash të bazuara në traditë, dhe ka filluar të jetë dëshmitar i disa ndryshimeve shoqërore, gjithnjë duke u rritur në një periudhë shumë intensive të inovacionit teknologjik.

GJETJET KRYESORE

- Familja përfaqëson institucionin më të rëndësishëm për rininë kosovare në lidhje me pothuajse të gjithë aspektet e jetës, pasi pothuajse të gjithë të anketuarit besojnë se familja është e nevojshme për të pasur një jetë më të mirë. Familja ofron qëndrueshmërinë që asnjë mik, punë ose situatë politike nuk mund ta ofrojë.
- Në përgjithësi, të rinjtë në Kosovë janë shumë të kënaqur me jetën e tyre. Fakti që vendi konsiderohet i pazhvilluar dhe të rinjtë janë të kënaqur me jetën e tyre, duhet të konsiderohet problematik, pasi të rinjtë janë më pak të motivuar për të kontribuar në zhvillimin e Kosovës. Të rinjtë në Kosovë janë shumë optimistë për të ardhmen e tyre dhe të ardhmen e shoqërisë së Kosovës. Vajzat dhe personat që jetojnë në zonat urbane janë më optimistë se të tjerët.
- Ka një rritje të dukshme në moshën e preferuar të martesës për meshkujt dhe femrat, me të paktën dy vjet në krahasim me studimin e mëparshëm të vitit 2012. Edhe pse të rinjtë planifikojnë të martohen dhe të kenë fëmijën e parë pas moshës 25 vjeçare, duan të kenë një numër të madh fëmijësh dhe familje të mëdha.
- Të rinjtë kryesisht nuk janë të kënaqur me cilësinë e arsimit në Kosovë. Vetëm 23 për qind mund të konsiderohen të kënaqur me cilësinë e arsimit dhe kjo është një nga shifrat më të ulëta në të gjithë rajonin. Për më tepër, Kosova është i vetmi vend që ka një përkeqësim në nivelin e kënaqësisë me cilësinë e arsimit. Më shumë se 56 për qind e të rinjve pranojnë se ka raste korrupsioni në institucionet/universitetet në Kosovë. Ky fenomen është më i përhapur në zonat urbane.
- Shumica e të rinjve që janë pjesë e tregut të punës nuk punojnë në profesionin e tyre. Si rezultat, ka një mospërputhje të madhe ndërmjet pritshmërisë së të rinjve për tregun e punës dhe nevojave ekzistuese për fuqi punëtore. Nga ana pozitive, të rinjtë të cilët kanë bërë stazh dhe praktikë gjatë studimeve të tyre duken se kanë shanse më të larta për të gjetur një punë në profesionin e tyre.
- Siguria e vendit të punës është faktori kryesor që të rinjtë e Kosovës konsiderojnë në zgjedhjen e një pune. Kjo nënkupton që ka një shqetësim të madh mbi të drejtat e punëtorëve, orët e gjata të punës, problemet me pagat, etj. Ata që janë më të shqetësuar për sigurinë e punës kanë një dëshirë më të lartë për të punuar në sektorin publik dhe janë më pak të kënaqur me cilësinë e arsimit në Kosovë. Në pesë vitet e

fundit ka një rritje të konsiderueshme të preferencave të të rinjve për të punuar në sektorin publik. Ky pëlqim për sektorin publik duket në pothuajse 70 për qind të të anketuarve.

- Vetëm 10 për qind e të rinjve kosovarë janë të mendimit se interesat e tyre përfaqësohen “mirë” në politikën kombëtare. Kjo pikëpamje mbi *mungesën e përfaqësimit* është pothuajse e njëjtë në aspektet kryesore demografike të popullatës së re (urbane, gjinia, mosha, etj.) Ka një rënie dramatike të interesimit të rinjve në ngjarjet politike në krahasim me 2012.
- Ekziston një nivel rekord mosbesimi dhe apatie e të rinjve në Kosovë drejt të gjitha institucioneve politike, veçanërisht për partitë politike dhe qeverisjen kombëtare. Për më tepër, ka një skepticizëm më të madh ndaj organizatave të shoqërisë civile dhe medias. Nga ana tjetër ka një besim tek institucionet fetare dhe organizatat ndërkombëtare si NATO dhe OSBE.

- Rreth gjysma e të rinjve shqiptarë të Kosovës kanë një qëllim nga i moderuar deri në shumë të fortë për t’u larguar nga Kosova. Arsyet ekonomike janë arsyeja kryesore për t’u larguar nga Kosova drejt një vendi tjetër. Nga ana tjetër, vetëm një e katërta e të rinjve nga Kosova që dëshirojnë të migrojnë kanë njohuri të mira të gjuhës së punës të vendit të planifikuar si destinacionin e tyre, duke treguar se nuk janë të përgatitur paraprakisht për migrimin.

3

METODOLOGJIA

METODA SASIORE

Një sondazh përfaqësues për të rinjtë e moshës 14–29 vjeç në Kosovë, që përfshin 1000 të anketuar të zgjedhur në mënyrë rastësore nëpërmjet një metodologjie specifike mostrimi. Një shtesë prej 150 anketash të rinjve serbë dhe 50 atyre turq të Kosovës iu shtua në mënyrë që të krijohej një nëngrup me numër të mjaftueshëm për analizë statistike domethënëse. Kjo shtesë do të peshohet kur të dhënat do të analizohen në nivel kombëtar; në këtë mënyrë të rinjtë serbë dhe turq nuk do të jenë të mbipërfaqësuar në të dhënat në nivel kombëtar. Në vend të kësaj, nuk do të përdoren pesha në krahasimin ndërmjet etnive; do të krahasohen tre nëngrupe me 969 të rinj shqiptarë, 181 të rinj serbë dhe 50 të rinj turq të intervistuar.

MARZHI I GABIMIT

Marzhi i gabimit për mostrën kombëtare (N=1000) është ± 3.1 për qind me një interval konfidence prej 95 për qind.

MOSTRIMI

Metoda e përdorur e kampionimit është një proces përzgjedhjeje me disa faza i stratifikuar. Përzgjedhja e të anketuarve është krye me tre hapa.

Hapi 1: Përzgjedhja e 100 Njësive Bazë të Kampionimit (NBK) në Kosovë.

Si njësi bazë të kampionimit për këtë anketë u përdorën zonat gjeografike të përcaktuara nga qendrat e votimit (QV). Për këtë qëllim u përdor lista e QV-ve e vitit 2010 e bërë publike nga Komisioni Qendror i Zgjedhjeve. Përzgjedhja e QV-ve u shtresëzua sipas rajoneve. Votuesit e regjistruar në QV do të shërbejnë si tregues për dendësinë e popullsisë në çdo zonë. Metoda e

përzgjedhjes është ajo e probabilitetit në përpjesëtim me madhësinë pa zëvendësim (PPM PZ) ku njësia e masës ishte numri i votuesve të regjistruar.

Hapi 2: Përzgjedhja e familjes brenda NJBK

Intervistuesit iu dha një pikënisje rastësore brenda Njesisë së Kampionimit të përzgjedhur. Duke përdorur metodën e rrugës rastësore, intervistuesit përzgjedhën çdo derë të k-th2 për të marrë pjesë në sondazh.

Hapi 3: Përzgjedhja e të anketuarit

Pasi arrihet të kontaktohet me familjen e përzgjedhur, intervistuesi do të krijojë një listë të anëtarëve të përhershëm të familjes të moshës 14–29 vjeçare.

- Nëse familja ka vetëm një anëtar të grup-moshës 14–29 vjeçare, anketuesi do të anketojë anëtarin e vetëm në moshë të re të familjes.
- Nëse familja ka dy ose më shumë anëtarë të grup-moshës 14–29 vjeç, intervistuesi do të marrë për intervistë anëtarin e/i cila/i ka festuar ditëlindjen e/i fundit.
- Nëse familja nuk ka anëtarë të grup-moshës 14–29 vjeç, intervistuesi do të përpiqet të kontaktojë për anketim me familjen e tretë.

MATJA

U përdorën dy matje. E para sipas gjinisë dhe e dyta sipas grup-moshës dhe gjinisë. Matja bëhet vetëm për të anketuarit përfaqësues.

TABELA 1: **Shpërndarja e moshës dhe gjinisë para dhe pas matjes**

| Kosovë | | | |
|--------|------------|------|------|
| Mosha | | Para | Pas |
| | 14–17 vjeç | 39 % | 27 % |
| | 18–23 vjeç | 37 % | 39 % |
| | 24–29 vjeç | 24 % | 34 % |
| Gjinia | Femra | 59 % | 48 % |
| | Meshkuj | 41 % | 52 % |

METODA CILËSORE

Si detyrë kryesore e fazës përgatitore, është hartuar udhëzimi për fokus grupe nga IDRA Research & Consulting, në konsultim të ngushtë me Fondacionin Friedrich-Ebert-Stiftung. Udhëzimi u hartua në mënyrë që të siguronte informacion më të hollësishëm të çështjeve specifike dhe rezultatet e metodës cilësore të kërkimit që kërkonin shpjegim dhe kuptim të mëtejshëm. Pjesë e udhëzimit ishin pyetje shtesë, jashtë anketimit si mbështetje për çështje specifike.

Brenda pesë ditëve, nga 21 deri 25 maj 2018, u organizuan gjashtë fokus grupe. Një seancë me fokus grup ka zgjatur mesatarisht dy orë. Përveç Prishtinës (3 grupe) u organizuan edhe grupe të tjera në Prizren (1), Gjilan (1), Mitrovicë (1). Tre grupe në Prishtinë u ndanë sipas grup-moshave 14–17, 18–24, 25–29 vjeç, ndërsa në vende të tjera ishte e përziera. Zona urbane/rurale, gjinia dhe statusi i punësimit ishin të përziera.

STRUKTURA E KAMPIONIMIT:

TABELA 2: **Shpërndarja e fokus grupeve**

| Vendndodhja | Urbane/Rurale | Gjinia | Mosha | Statusi i punësimit |
|--|---------------|------------|------------|---|
| Prishtinë (përfshirë Podujevë, Drenas, Lipjan) | E përziera | E përziera | 14–17 | Studentë |
| Prishtinë (përfshirë Podujevë, Drenas, Lipjan) | E përziera | E përziera | 18–24 | Gjysma e grupit studentë dhe të papunë/gjysma të punësuar |
| Prishtinë (përfshirë Podujevë, Drenas, Lipjan) | E përziera | E përziera | 25–29 | Gjysma studentë dhe të papunë/gjysma të punësuar |
| Prizren (përfshirë Suhareka dhe Dragash) | E përziera | E përziera | E përziera | Gjysma studentë dhe të papunë/gjysma të punësuar |
| Gjilan (përfshirë Viti dhe Kamenica) | E përziera | E përziera | E përziera | Gjysma studentë dhe të papunë/gjysma të punësuar |
| Mitrovica (përfshirë Vushtrri dhe Skënderaj) | E përziera | E përziera | E përziera | Gjysma studentë dhe të papunë/gjysma të punësuar |

4

VLERAT, FEJA DHE BESIMI

Vlerat, sjelljet dhe besimet janë aspekte shumë të rëndësishme që do të përcaktojnë të ardhmen e të rinjve të Kosovës dhe shoqërisë së tyre. Mjedisi shoqëror i kohëve të fundit dhe i të shkuarës ka luajtur një rol jetik në ormësimin e vlerave, besimeve dhe sjelljes së të rinjve në shoqëri. Si rezultat, ndryshimet e këtyre faktorëve janë treguesi kryesor i ndryshimeve në mjedisin shoqëror.

Shoqëria kosovare mbetet e lidhur me vlerat tradicionale. Këto vlera theksojnë më tepër vlerat tradicionale të familjes, respektin ndaj autoritetit, rëndësinë e fesë, rëndësinë e martesës dhe besnikërinë ndaj partnerit (Inglehart & Welzel, 2016).

GJETJET KRYESORE

- Vlera më e rëndësishme e të rinjve kosovarë është të qenit besnik ndaj partnerit, pasi 87 për qind e tyre e konsiderojnë si shumë të rëndësishme. Për më tepër, një tjetër 77 për qind konsiderojnë se fëmijët janë shumë të rëndësishëm, dhe 70 për qind e konsiderojnë martesën si po aq të rëndësishme. Ky është një tregues i fortë i vlerave tradicionale dhe familjes si vlera kryesore e të rinjve kosovarë.
- Nga ana tjetër, ekziston një nivel i lartë mospjesëmarrjeje në veprimet qytetare dhe politike, pasi vetëm 10–16 për qind e të rinjve i konsiderojnë këto aspekte si shumë të rëndësishme. Si i tillë, ka mangësi në lidhjen e të rinjve që mund të grupohen së bashku për të qenë më bashkëpunues për dobi të përbashkëta.
- Në përgjithësi, të rinjtë në Kosovë janë shumë të kënaqur me jetën e tyre (64 për qind). Fakti që vendi konsiderohet i pazhvilluar dhe ata janë të kënaqur me jetën e tyre, duhet të konsiderohet problematik, pasi të rinjtë janë më pak të motivuar për të kontribuar në zhvillimin e Kosovës.
- Rinia kosovare ka mbështetje të fortë në jetën familjare, që nxit optimizmin personal dhe social. Të rinjtë kosovarë shprehën shumë të kënaqur me jetën e tyre në krahasim me homologët e tyre në rajon, megjithëse janë pjesë e një vendi me zhvillim social-ekonomik më të ulët.
- Të rinjtë në Kosovë janë tepër optimistë për të ardhmen e tyre personale. Ata janë gjithashtu shumë optimistë për të ardhmen e shoqërisë së Kosovës. Vajzat dhe personat që jetojnë në zonat urbane janë më optimistë se të tjerët. Shqiptarët kosovarë janë optimistë për të ardhmen e Kosovës në 10 vitet e ardhshme, pasi 71 për qind besojnë se e ardhmja do jetë më e mirë.
- Korrupsioni është çështje shumë shqetësuese për rininë e Kosovës. Korrupsioni përbën ndryshim, pasi është veçuar si çështje mjaft shqetësuese nga 56 për qind e të rinjve.
- Pavarësisht se Kosova ka një të shkuar me konflikt etnik, vetëm 18 për qind e të rinjve ndihen të frikësuar apo shqetësuar për konflikte të ngjashme në rajon apo në botë.
- Sondazhi zbulon lajme të mira lidhur me faktin se rinia kosovare nuk justifikon ryshfetin dhe mashtrimin me taksa. Niveli prej 87 për qind të të rinjve që nuk do të justifikonin kurrë mashtrimin me taksa tregon një moral të lartë tatumor që reflekton një mbështetje të qëndrueshme për shtetin në përgjithësi, megjithëse ka një nivel të ulët besimi në institucionet kryesore publike, me përjashtim të policisë dhe ushtrisë.
- Të rinjtë në Kosovë janë shumë rezistentë ndaj ryshfetit, por jo aq shumë ndaj njohjeve, megjithëse gjysma e tyre nuk do ta justifikonin kurrë përdorimin e njohjeve për gjetjen e një vendi pune ose për kryerjen e punëve.
- Të rinjtë e Kosovës kanë besimin më të lartë të mundshëm tek anëtarët më të afërt të familjes. Pas anëtarëve të familjes, niveli i besimit zvogëlohet ndjeshëm. Të rinjtë kanë një nivel

më shumë se mesatar besimi për fëmijët dhe shokët/shoqet e klasës.

- Më shumë se një e treta e të rinjve kosovarë mund të konsiderohen si shumë të lidhur me fenë, pasi ndjekin shërbimet fetare një herë në muaj ose më shpesh. Meshkujt duket se janë më besimtarë se femrat. Ekziston një lidhje e fortë ndërmjet pjesëmarrjes në shërbime fetare nga të rinjtë dhe nivelit të perceptimit të fesë nga prindërit e tyre.


Vlera më e rëndësishme e të rinjve kosovarë është të qenit besnik ndaj partnerit, pasi 87 për qind e të rinjve në Kosovë e konsiderojnë si shumë të rëndësishme. Për më tepër, një tjetër 77 për qind konsiderojnë se fëmijët janë shumë të rëndësishëm, dhe 70 për qind e konsiderojnë martesën si po aq të rëndësish-

me. Ky është një tregues i fortë i vlerave tradicionale dhe familjes si vlera kryesore e të rinjve kosovarë. Disa qëllime të tjera të rëndësishme përfshijnë marrjen e diplomës universitare si shumë të rëndësishme në 72 për qind të rasteve, ndërsa 70 për qind konsiderojnë pasurimin si shumë të rëndësishëm. Shumica e këtyre qëllimeve dhe vlerave kanë një qasje individuale.


Nga ana tjetër, ekziston një nivel i lartë mospjesëmarrje në veprimet qytetare dhe politike, pasi vetëm 10–16 për qind e të rinjve i konsiderojnë këto aspekte si shumë të rëndësishme. Duke qenë kështu, ka mangësi në lidhjen e të rinjve që mund të grupohen së bashku për të qenë më bashkëpunues për përfitime të përbashkëta.

Në përgjithësi, të rinjtë në Kosovë janë të kënaqur me jetën e tyre. Fakti që Kosova konsiderohet nga Banka Botërore si një


DIAGRAMI 4.1: **Vlerat më të rëndësishme për të rinjtë në Kosovë**



DIAGRAMI 4.2: **Kënaqësia e të rinjve me jetesën në Kosovë**



DIAGRAMI 4.3: **Përqindja e të rinjve të cilët thonë se janë shumë të kënaqur me jetën e tyre**



shtet me të ardhura mesatare të ulëta, dhe të rinjtë janë të kënaqur me jetën e tyre, duhet të konsiderohet problematik, pasi ata janë më pak të motivuar për të kontribuar në zhvillimin e Kosovës. Gjithashtu ekzistojnë lidhje të rëndësishme statistike në lidhje me kënaqësinë e të rinjve me jetën e tyre në përgjithësi. Të rinjtë që i përkasin grupit më të ri janë më të kënaqur me jetën e tyre, dhe kënaqësia zvogëlohet në grupmoshat e tjera (Spearman's rho=-.154, p<0.001). Të rinjtë që janë pjesë e familjeve në një gjendje më të mirë ekonomike zakonisht janë më të kënaqur me jetët e tyre (Spearman's rho=.061, p=0.043). Për më tepër, personat që janë të kënaqur janë më pak të prirë për të migruar në të ardhmen e afërt (Spearman's rho=-.129, p<0.001). Në përgjithësi, personat që janë më të kënaqur me jetët e tyre kanë një këndvështrim më të mirë të sistemit arsimor (Spearman's rho=.114, p<0.001), dhe janë gjithashtu të kënaqur me gjendjen e demokracisë në Kosovë (Spearman's rho=.062, p=0.041).

Rinia kosovare ka mbështetje të fortë në jetën familjare, që nxit optimizmin personal dhe social. Të rinjtë kosovarë shprehen shumë të kënaqur me jetën e tyre në krahasim me homologët e tyre në rajon, megjithëse janë pjesë e një vendi me zhvillim social-ekonomik më të ulët. Vihet re se të rinjtë nga vendet e Bashkimit Evropian janë në përgjithësi më pak të kënaqur me jetët e tyre. Shtetet e zhvilluara në rajon (Slovenia, Kroacia dhe Bullgaria) janë më të përparuara në procesin e individualizimit të të rinjve, duke i hequr ndjesinë e përkatësisë familjare. Si rezultat, rinia në këto vende ka më shumë ambicie për rritjen personale ndërsa kanë më pak mbështetje nga familjet e tyre, çka sjell një

ndjenjë pakënaqësie. Nga ana tjetër, të rinjtë në Kosovë janë shumë të kënaqur me mbështetjen nga familja dhe prirjen të kenë një nivel më të ulët individualizimi dhe bëjnë më pak përpjekje për zhvillimin e tyre personal.


Diskutimi në grupe u përqendrua në domosdoshmërinë e familjes si pasuria më e madhe, dhe si diçka për të qenë krenar. Vlera dhe karakteristika të tjera konsiderohen: respekti për prindërit, krenaria dhe morali i fortë. Një shembull i moralit të fortë mund të konsiderohet ekzistenca e rasteve të rralla të divorcit. *"Në vendet e tjera njerëzit martohen kur pëlqejnë dikë dhe nëse gjërat nuk shkojnë mirë, divorcohen. Tek ne nuk është e njëjta gjë. Ne tolerojmë shumë për shkak të moralit dhe familjes dhe nuk mendojmë për veten tonë si individualist"* (Prishtinë, femër, 24 vjeç)

Të rinjtë në Kosovë janë shumë optimistë për të ardhmen e tyre. Gjithashtu, ata janë optimistë për të ardhmen e Kosovës. Vajzat janë më optimiste (Spearman's rho=-.086, p=0.005). Të rinjtë që i përkasin grupit të të rinjve më të moshuar (24–29 vjeç) janë në përgjithësi më pak optimistë për të ardhmen e tyre pas 10 vjetësh krahasuar me grupmoshat e tjera (Spearman's rho=-.138, p<0.001).


Personat që mendojnë se kanë një të ardhme personale më të mirë në përgjithësi kanë një këndvështrim më të mirë për sistemin arsimor (Spearman's rho=.065, p=0.037), dhe janë të kënaqur me gjendjen e demokracisë në Kosovë (Spearman's rho=.066, p=0.033).

Shqiptarët e Kosovës janë optimistë për të ardhmen e Kosovës në 10 vitet e ardhshme, ku 71 për qind e të rinjve besojnë se e ardhmja do jetë më e mirë. Nga ana tjetër, vetëm 7 për qind e të rinjve shqiptarë të Kosovës mund të konsiderohen si pesimistë.


DIAGRAMI 4.4: **Si e shihni të ardhmen tuaj pas 10 vjetësh?**



DIAGRAMI 4.5: **Opinionit i të rinjve për të ardhmen e Kosovës**



DIAGRAMI 4.6: **Shqetësimet e të rinjve në Kosovë**



Më shumë se një e treta e serbëve të Kosovës e shmangin pyetjen mbi të ardhmen e Kosovës, dhe 37 për qind mendojnë se e ardhmja do jetë njëloj ose më keq.

rinjve janë të frikësuar ose të shqetësuar për konflikte të ngjashme në rajon apo në botë.


TË FRIKËSUAR OSE TË SHQETËSUAR

Korrupsioni është çështje kryesore shqetësuese për të rinjtë në Kosovë. Korrupsioni përbën ndryshim, pasi është veçuar si çështje mjaft shqetësuese nga 56 për qind e të rinjve. Më shumë se një e treta e të rinjve konsiderojnë si problematike çështjet e varfërisë dhe padrejtësisë sociale. Megjithatë familjet kosovare përjetuan një konflikt etnik në fund të viteve '90, vetëm 18 për qind e të

SJELLJET DHE ARSYETIMI I TYRE


Sondazhi zbulon lajme të mira lidhur me faktin se rinia kosovare nuk justifikon ryshfetin dhe mashtrimin me taksa. Niveli prej 87 për qind të të rinjve që nuk do të justifikonin kurrë mashtrimin me taksa tregon një moral të lartë tatomor që reflekton një mbështetje të qëndrueshme për shtetin në përgjithësi, megjithatë ka një nivel të ulët besimi në institucionet kryesore publike, me përjashtim të policisë dhe ushtrisë. Në këtë rast ka shumë pak lidhje

DIAGRAMI 4.7: Sjelljet që mund të justifikohen ose jo



DIAGRAMI 4.8: Deri në çfarë mase u besoni njerëzve të listuar në vijim?

Imagjinoni një shkallë vlerash prej 1 në 5, ku 1 nënkupton aspak besim dhe 5 shumë besim.



të rëndësishme statistikore. Ata të cilët justifikojnë mashtrimin me taksat janë gjithashtu ata të cilët justifikojnë përdorimin e njohjeve për të kryer punë. (Spearman’s rho=.250, p<0.001). Për më tepër, të rinjtë që jetojnë në zona urbane janë më të prirë të mashtrojnë me taksat në krahasim me të rinjtë e tjerë. (Spearman’s rho=-.112, p<0.001).

Nga ana tjetër, ka një pranim shumë të ulët të abortit dhe homoseksualitetit.

Të rinjtë në Kosovë janë shumë rezistentë ndaj ryshfetit, por jo aq shumë ndaj njohjeve, megjithëse gjysma e tyre nuk do e justifikonin kurrë përdorimin e njohjeve për gjetjen e një vendi pune ose për kryerjen e punëve. Të rinjtë që jetojnë në zona urbane janë më të orientuar për të përdorur lidhjet e tyre (Spearman’s rho=-.115, p<0.001). Për më tepër, të rinjtë që nuk janë të kënaqur me jetën e tyre në përgjithësi janë më të prirë të justifikojnë njohjet për të gjetur një vend pune (Spearman’s rho=-.129, p<0.001). Çuditërisht, personat që ndjekin më shpesh shërbimet fetare priren të justifikojnë njohjet me qëllim gjetjen e një pune (Spearman’s rho=.092, p=0.003).


BESIMI

Të rinjtë e Kosovës kanë besimin më të lartë të mundshëm tek anëtarët më të afërt të familjes. Pas anëtarëve të familjes, niveli i besimit zvogëlohet ndjeshëm. Besimi është përbërës kyç për një shoqëri më të bashkuar që mund të nxisë politika dhe një jetë më të mirë. Të rinjtë kanë një nivel më shumë se mesatar besimi për miqtë dhe shokët/shoqet e klasës.


Të rinjtë në Kosovë kanë një tolerancë të lartë për refugjatët të mundshëm. Për më tepër, familjet rome kanë një nivel pranimi pak më të lartë se mesatarja. Nga ana tjetër, ekziston një nivel i lartë i distancës sociale, si tregues i pranimit të ulët të diversitetit, kur të rinjtë u pyetën rreth personave të varur nga droga, ish të burgosur dhe homoseksualë.

Pakicat seksuale janë grupi i popullsisë që vuan nivelin më të lartë të intolerancës, me përjashtim të personave të varur nga droga. Ka disa lidhje të rëndësishme statistikore, kur analizojmë pranimin e idesë së të pasurit si fqinj, një homoseksual apo çift homoseksualësh. Të rinjtë meshkuj (Spearman’s rho=-.140, p<0.001) dhe të rinjtë që jetojnë në zona urbane (Spearman’s rho=-.119, p<0.001) janë më pak tolerantë ndaj homoseksualitetit. Për më tepër, personat që ndjekin më shpesh ritet fetare ka

DIAGRAMI 4.9: Si do të ndjeheshit nëse njerëz si në vijim do të vendoseshin për të jetuar në lagjen tuaj?



DIAGRAMI 4.10: Sa shpesh merrni pjesë në shërbesa fetare (përveç dasmave dhe funeraleve)?



gjasa të jenë kundër pranimin të homoseksualëve (Spearman's $\rho = -.097$, $p = 0.002$). Të rinjtë nga familje me një gjendje më të mirë ekonomike janë më tolerantë ndaj homoseksualëve (Spearman's $\rho = .92$, $p = 0.003$). Personat që kanë moral tatimor më të ulët janë më të prirë të pranojnë homoseksualët si fqinj.

PËRKATËSIA FETARE

Përkatësia fetare e të rinjve kosovarë përcaktohet tërësisht nga grupet e tyre etnike. Shumica e shqiptarëve janë myslimanë në 97 për qind të rasteve dhe vetëm 1 për qind pranojnë se nuk i përkasin ndonjë përkatësi fetare. Nga ana tjetër, 98 për qind e serbëve të Kosovës janë ortodoksë.


Rreth 36 për qind e të rinjve në Kosovë mund të konsiderohen të lidhur ngushtë me fenë, pasi ndjekin shërbimet fetare të paktën një herë në muaj. Meshkujt janë më besimtarë se femrat (Spearman's $\rho = .219$, $p < 0.001$).

Ka shumë pak tregues që kanë rëndësi statistikore mbi shpeshësinë e pjesëmarrjes në shërbime fetare. Megjithatë, të rinjtë në Kosovë që mendojnë se vendi duhet të anëtarësohet në BE, duket se janë më pak besimtarë (Spearman's $\rho = -.100$, $p = 0.001$).


Vetëm 7 për qind e prindërve nuk janë besimtarë krahasuar me 19 për qind e të rinjve që ndjekin shërbimet fetare vetëm një herë në vit apo praktikisht kurrë. Ka një lidhje të fortë ndërmjet pjesëmarrjes së të rinjve në shërbesa fetare dhe nivelin të perceptimit të besimit të prindërve të tyre (Spearman's $\rho = .329$, $p < 0.001$). Gjysma e të rinjve që kanë familje besimtare tregojnë ende nivel të lartë të pjesëmarrjes në shërbime fetare, duke treguar një kalim apo trashëgimi të konsiderueshme të sjelljes fetare. Familjet e moderuara besimtare duket se kanë një shpërndarje më neutrale të pjesëmarrjes së anëtarëve të rinj të familjes në shërbime fetare.

Pjesëmarrësit në fokus grupe e konsideruan veten si myslimanë liberalë. Besimi shihet si çështje personale dhe nuk imponohet mbi të tjerët. "Vitin e kaluar, një shoku im amerikan erdhi për vizitë në Kosovë duke menduar se do të gjente një vend mysliman, të pasigurt dhe konservator. Kur erdhi pa njerëz normal që konsumin alkool. Besimi nuk ndikon në mënyrën tonë të jetesës" (Prishtinë, Meshkuj, 25 vjeç)

DIAGRAMI 4.11: Besimi fetar i etnive kryesore



DIAGRAMI 4.12: Besimi fetar i prindërve dhe praktikimi i riteve fetare nga të rinjtë



DISKUTIM

Brezi i ri kosovar vazhdon t’i japë një rëndësi të veçantë familjes dhe ngjarjeve të tjera të ngjashme, shumë më shumë krahasuar me miqtë dhe punën.

Ekziston një nivel i ulët tolerance ndaj korrupsionit, mashtrimit me taksa dhe ryshfetit, që mund të përdoret si bazë e fortë për të mbështetur politikat e sektorit publik. Niveli i lartë i moralit tatimor mund të përdoret për të përkrahur politikat rinore që kanë nevojë për shpenzime shtesë dhe ndryshime në sistemin tatimor. Nga ana tjetër, forma më e tërthortë e “lojës së padrejtë” ka shkallë më të ulët refuzimi.

5

MËNYRA E JETESËS DHE KOHA E LIRË

Brezi i të rinjve 14–29 vjeç kanë lindur në fund të viteve '80-të dhe '90-të dhe janë rritur në zhvillimin e shpejtë të teknologjisë, internetit dhe pajisjeve. Mënyra e jetesës varet nga sjelljet, morali, vlerat, preferencat dhe mundësitë e një personi. Aktivitetet e kohës së lirë përbëjnë një pjesë të rëndësishme të mirëqenies së të rinjve jashtë punës, shkollës dhe detyrimeve familjare, dhe mund të korrespondojnë me aspiratat dhe pasionet e vërteta të tyre. Mënyra se si e shpenzojnë kohën e lirë të rinjtë mund të ndikojnë në shumë aspekte aktivitetin e tyre shoqëror.

Ky studim përfshinë një sërë pyetjesh lidhur me mënyrën e jetesës së të rinjve në Kosovë. Ky grup pyetjesh synon të përcaktojë mënyrën se si e kalojnë kohën e lirë të rinjtë dhe si sillen në disa aktivitete që përmbajnë rreziqe.


GJETJET KRYESORE

- Të pyetur mbi aktivitetet që bëjnë më shpesh të rinjtë në Kosovë, ata e përqendrojnë kohën e tyre të lirë 'duke kaluar kohë me familjen' si aktiviteti i përmendur më shpesh. Dëgjimi i muzikës dhe shikimi i filmave janë mënyrat më të përhapura të kalimit të kohës.
- Më pak se gjysma e të rinjve dalin me miqtë dhe nuk bëjnë asgjë. Kjo është shumë e përhapur tek pjesëmarrësit në fokus grupe dhe është zakonisht në formën e kalimit të kohës në bare.
- Shumica (56 për qind) e rinisë në Kosovë qasen në internet gjatë gjithë kohës në çdo mënyrë (Wi-Fi, smart phone, publik, PC dhe/ose mënyra të tjera). Kjo është më e përhapur tek djemtë, zakonisht në zona urbane, dhe nga familje në gjendje të mirë ekonomike.
- Arsytet kryesore për përdorimin e internetit në pothuajse 85 për qind të rasteve janë të lidhura me komunikimin dhe mba-

jtjen në kontakt me të afërmit dhe miqtë. Gjysma e të anketuarve e përdorin internetin për arsimim ose punë.

- Duhanpirja nuk ka ndryshuar që nga viti 2012, pasi 71 për qind e të rinjve nuk janë duhanpirës. Nëntëmbëdhjetë për qind e meshkujve janë duhanpirës të rregullt, dhe vetëm shtatë për qind e femrave konsumojnë duhan rregullisht. Të rinjtë nga familje në një gjendje më të mirë ekonomike janë më shumë të prirë për të pirë duhan.
- Edhe konsumimi i alkoolit nuk ka ndryshuar në gjashtë vitet e fundit, pasi sipas rezultateve të sondazhit, përsëri 73 për qind e të rinjve në Kosovë nuk konsumojnë alkool. Të rinjtë në zonat urbane janë më shumë të prirur për të konsumuar alkool. Të rinjtë që marrin pjesë më shpesh në shërbimet fetare prirën të refuzojnë alkoolin, megjithëse kjo nuk vlen për duhanpirjen.
- 46 për qind e të rinjve në Kosovë pohojnë se nuk kanë kryer marrëdhënie seksuale. Nga ana tjetër, 19 për qind e tyre nuk u përgjigjen apo nuk ndiheshin rehat për t'u përgjigjur.
- Kontraceptivët përdoren nga 40 për qind e të rinjve që kanë pasur eksperiencë seksuale. Ka një lidhje statistikisht të rëndësishme të lartë ndërmjet përdorimit të kontraceptivëve dhe të rinjve që konsumojnë alkool, që janë pjesë e familjeve në gjendje më të mirë ekonomike, dhe që kanë përfunduar nivele të larta arsimit.

Sondazhi prezanton një listë aktivitetesh për të anketuarit dhe ata përgjigjen duke treguar sa shpesh i kryejnë ato. Është e qartë se 'kalimi i kohës me familjen' është aktiviteti më i përmendur (70 për qind shumë shpesh dhe 23 për qind shpesh). Lidhja me familjen do të diskutohet më hollësisht në vijim të studimit. Megjithëse koha e lirë supozohet që t'i largojë nga detyrimet e përditshme të shkollës, punës apo familjes, të rinjtë kosovarë e konsiderojnë familjen si një mënyrë shumë të rëndësishme për të shpenzuar

DIAGRAMI 5.1: **Aktivitetet e kohës së lirë**

kohën e lirë. ‘Dëgjimi i muzikës’, ‘shikimi i filmave’ dhe ‘dalja me miqtë’ janë ndër aktivitetet më të shpeshta që bëjnë të rinjtë në Kosovë. ‘Falja’ duket se luan një rol të rëndësishëm në jetën e përditshme të të rinjve (18 për qind ‘shumë shpesh’ dhe 18 për qind ‘shpesh’). Nga ana tjetër, të rinjtë në Kosovë duket se nuk janë të përfshirë në aktivitete në kuadër të vullnetarizmit si ‘shpenzimi i kohës në qendrat e rinisë’ apo duke u bërë pjesë e punëve të përbashkëta si ‘bërja e diçkaje kreative’ apo pjesëmarrja në sporte. Kur krahasojmë rezultate gjinore, sondazhi paraqet diferencë të madhe të disa aktiviteteve për të cilat të anketuarat femra kalojnë më pak kohë se meshkujt. Kjo tendencë është paraqitur në shumë gjetje të këtij studimi. Femrat priren të ‘lexojnë libra’ më shumë se meshkujt, por ‘dalin me miqtë’, ‘kalojnë kohë në bare, kafe, klube’, ‘aktivitete sportive’ dhe ‘luajnë video games’ më pak. Për më tepër, të dhënat tregojnë se nuk ka ndryshime të konsiderueshme në lidhje me urbanizimin (zona urbane kundrejt rurale), duke përfshirë aktivitetin ‘dalje me miqtë’.

TABELA 3: Lidhja ndërmjet aktiviteteve të kohës së lirë

| rho e Spearmanit | Dëgjimi i muzikës | Shikimi i filmave | Aktivitete sportive | Aktivitete kreative | Punë vullnetare | Kalimi i kohës në bare |
|---------------------------|-------------------|-------------------|---------------------|---------------------|-----------------|------------------------|
| Kalimi i kohës me familje | .190** | .210** | -.096** | -.071* | -.190** | |
| Dëgjimi i muzikës | | .212** | .079** | .086** | | .209** |
| Shikimi i filmave | | | | | | .130** |
| Dalja me miq | .315** | .133** | .293** | | .140** | .604** |
| Asgjë/dalja me miq | | | .064* | .097** | | .249** |
| Leximi i librave | | .067* | .081** | .301** | .130** | |

Rreth 44 për qind e të rinjve kosovarë shpesh rrinë dhe nuk bëjnë asgjë, 22 për qind e bëjnë shpesh dhe 20 për qind e bëjnë shumë shpesh. Kjo është më e mundshme tek të anketuarit e rinj.

Dalja dhe mosbërja e asnjë gjëje ishte çështja kryesore e diskutimeve të fokus grupit. Pjesëmarrësit i përshkruan të rinjtë si të paangazhuar dhe me një mungesë perspektive. Ata kalonin kohë në kafe dhe bare për të krijuar kontakte dhe lidhje të reja për mundësi punësimi. “Unë mendoj se tipari kryesor i rinisë kosovare është koha e kaluar në kafe dhe bare. Mbase nuk kemi aktivitete të tjera që të jemi të zënë.” (Prizren, Meshkuj, 29 vjeç)

Në përgjithësi, të anketuarit që shikojnë televizor thanë se harxhojnë mesatarisht 2.2 orë në ditë duke parë televizor. Të anketuarat femra harxhojnë pak më shumë kohë sesa meshkujt, veçanërisht në zonat rurale. Rreth 5 për qind e të anketuarve deklaruan se shikojnë TV 4–6 orë në ditë.

Gjetjet tregojnë se shumica (56 për qind) e të rinjve në Kosovë kanë qasje në internet “praktikisht gjatë gjithë kohës” në çdo mënyrë (Wi-Fi, smart phone, publik, PC dhe/ose mënyra të tjera). Ndërsa rreth 40 për qind e të anketuarve thonë se kanë qasje në internet ‘çdo ditë apo pothuajse çdo ditë’. Ky rezultat sugjeron se të rinjtë kanë qasje në internet të paktën çdo ditë. Ka disa ndry-

Nga ana tjetër, 23 për qind e të rinjve nuk kanë lexuar kurrë libra. Për më tepër, më shumë se 70 për qind e të rinjve nuk kanë qenë kurrë vullnetarë në projekte apo iniciativa shoqërore. Në të njëjtën kohë, pothuajse 70 për qind e të rinjve nuk kanë qenë kurrë jashtë. “Të dalurit jashtë shtetit” është ndikuar nga regjimi i vizave për Kosovën, pasi shumica e të rinjve nuk kanë qenë kurrë në vende të Bashkimit Evropian.


Tabela e lidhjes ndërmjet aktiviteteve më të rëndësishme tregon kombinime të ndryshme. Të rinjtë që pëlqejnë të kalojnë kohë me familjen janë më të prirë për të kryer aktivitete pasive si dëgjimi i muzikës apo shikimi i filmave, por janë më pak të prirë të bëjnë aktiviteteve sportive, argëtimi apo vullnetarizmi. Të rinjtë që pëlqejnë të dalin me miqtë kanë lidhje më të mëdha me aktivitete të tjera, veçanërisht me kalimin e kohës në bare dhe aktivitete sportive.

hime të vogla kur i referohemi rezultateve të urbanizimit dhe gjinore, si femrat (veçanërisht në zonat rurale) kanë më pak qasje në internet krahasuar me meshkujt (Spearman’s rho=.085, p=0.005). Të rinjtë pjesë e familjeve në gjendje më të mirë ekonomike (Spearman’s rho=.105, p<0.001) dhe prindërit me një nivel më të lartë arsimimi education (Spearman’s rho=.116, p<0.001) zakonisht e përdorin internetin në mënyrë më intensive.


Të dhënat e sondazhit tregojnë se arsyet kryesore të përdorimit të shpeshtë të internetit, që do të thotë të paktën një herë në javë, janë të lidhura me komunikimin dhe mbajtjen në kontakt me të afërmit dhe miqtë. Rreth gjysma e të anketuarve (51 për qind) deklaruan se e përdorin më shpesh internetin për qëllime profesionale si pune apo shkolle, rreth 43 për qind e të rinjve në Kosovë e përdorin shpesh internetin për t’u përditësuar apo informuar. Nga ana tjetër, përdorimi i internetit për online banking apo blerje online është në nivele të ulëta.

Diskutimet në grupet e fokusit e konsideronin *smartphone* si të abuzuar dhe që pengon komunikimin në jetën reale. Pjesëmarrësit mendojnë se interneti është duke u përdorur shumë për rrjetet sociale. Nga ana tjetër një pjesë e të rinjve kanë aftësi të mira të IT-së dhe një numër i madh i tyre janë duke u punësuar nga

DIAGRAMI 5.2: **Qasja në internet**




DIAGRAMI 5.3: **Arsyet kryesore për përdorimin e internetit**



kompanitë e huaja për të punuar online apo për të qenë të vetë-punësuar. Programimi është bërë një fushë prestigjioze dhe një profesion i përhapur në mesin e të rinjve.

Është veçanërisht e rëndësishme për të theksuar se koha e lirë shpesh shoqërohet me sjellje të rrezikshme, si konsumimi i alkoolit, sjellje seksuale të rrezikshme dhe të tjera si këto. Sjelljet e rrezikshme të të rinjve shpesh rezultojnë si seri e shkaqeve dhe situatave që të rinjtë kanë brenda apo jashtë familjes së tyre, duke përfshirë faktorë të ndryshëm socialë, ekonomikë e të tjerë.

DIAGRAMI 5.4: **Kënaqësia me pamjen fizike**




shumë të kënaqur se si duken; 35 për qind janë të kënaqur, 13 për qind janë mesatarisht të kënaqur dhe vetëm 10 për qind janë të pakënaqur apo shumë të pakënaqur me pamjen e tyre.

Parametrat e kënaqësisë me pamjen nuk ndikohen nga mosha, vendi, arsimimi. I vetmi ndryshim statistikiqsh i rëndësishëm lidhet me gjininë, pasi meshkujt duken pak më të kënaqur se vajzat (Spearman’s rho=.060, p=0.048).


TË QENIT I KËNAQUR ME PAMJEN E JASHTME

“Dukja bukur” nuk është më prioritet kryesor për të rinjtë në Kosovë, pasi vetëm 52 për qind e tyre e konsiderojnë si “shumë të rëndësishëm”. Megjithatë, duket se shumica e të rinjve kanë një imazh pozitiv për veten, pasi 73 për qind e tyre ishin të kënaqur me paraqitjen e tyre, ose më saktë, 38 për qind mendojnë se janë

DIAGRAMI 5.5: A pini duhan?



DIAGRAMI 5.6: A pini alkool? (N=1.000)



SJELLJET E RREZIKSHME

Sipas rezultateve të anketës, 71 për qind e të rinjve nuk pinë duhan dhe ky rezultat është identik me të njëjtën anketë të vitit 2012. Nëntëmbëdhjetë për qind e meshkujve duket se janë duhanpirës të rregullt, ndërsa vetëm shtatë për qind e vajzave pinë rregullisht duhan. Duhanpirja rregullisht mbizotëron midis të rinjve të moshave 24–29 vjeç, dhe përqindja e jo-duhanpirësve zvogëlohet me rritjen e moshës, megjithëse përqindja e atyre që pinë duhan me raste është e njëjtë ndërmjet grupmoshave të ndryshme të të rinjve (9–11 për qind).

Zakonet e duhanpirjes janë të lidhura me rezultatet e indeksit të pasurisë, pasi të rinjtë që i përkasin familjeve në gjendje më të mirë ekonomike, kanë prirje më të forta për të pirë duhan (Spearman's rho=.084, p=0.006). Serbët e Kosovës duken se janë më

shumë duhanpirës se shqiptarët e Kosovës. (Spearman's rho=.226, p<0.001).


Pjesëmarrësit në fokus grupe pohuan se duhanpirja është ndikuar nga shokët dhe këngëtarë të famshëm. Blerja e cigareve është shumë e thjeshtë pasi shiten në çdo dyqan afër shkollave me një çmim nga 0,10–0,20 Euro dhe limiti moshës nuk respektohet. “Ata mund të blejnë cigare aq lehtësisht sa mund të blihet bukë” (Pristinë, Meshkuj, 28 vjeç). Arsyeja më e përhapur e duhanpirjes është “të qenurit i përfshirë” dhe “thyerja e rregullave”.

Në bazë të rezultateve të anketimit, 73 për qind e të rinjve nuk konsumojnë alkool dhe rezultatet nuk kanë ndryshuar në gjashtë vitet e fundit. Pesë për qind e të rinjve raportojnë konsumimin e alkoolit të paktën disa herë në javë. Përgjithësisht, konsumimi i alkoolit është i përhapur në 25 për qind të të rinjve, duke përfshirë ata që pinë rregullisht dhe ata që janë konsumues të rrallë.

Konsumimi është 33 për qind për meshkujt dhe vetëm 16 për qind për femrat.

Nuk është për t'u habitur që konsumimi i alkoolit gjatë javës rritet me moshën nga 5 deri 17 për qind. Duhanpirja dhe konsumimi i alkoolit në rini është shumë i ndërlidhur (Spearman's rho=.440, $p<0.001$). Për më tepër, konsumimi i alkoolit lidhet me indeksin e pasurisë, pasi të rinjtë që i përkasin familjeve në një gjendje të mirë ekonomike priren më tepër për të konsumuar alkool (Spearman's rho=.241, $p<0.001$). Siç pritej, të rinjtë në zonat urbane kanë një prirje më të fortë për të pirë, krahasuar me grupin e tyre të bashkëmoshatarëve ruralë (Spearman's rho=-.062, $p=0.041$). Për më tepër, të rinjtë që marrin pjesë më shpesh në shërbime fetare, janë më të prirë të refuzojnë konsumimin e alkoolit (Spearman's rho=-.140, $p<0.001$).

Në bazë të gjetjeve sasiore, konsumimi i alkoolit është i pranueshëm për 60 për qind të të anketuarve. Për më tepër, pranimi pjesërisht i përdorimit të alkoolit është statistikiqisht i lidhur me gjininë, rezidencën, moshën dhe indeksin e pasurisë së të anketuarve. Profili i të rinjve që konsiderojnë alkoolin më të pranueshëm është meshkuj (Spearman's rho=.127, $p<0.001$), që jeton në zona urbane (Spearman's rho=-.120, $p<0.001$), me arsim të lartë (Spearman's rho=-.120, $p<0.001$), dhe duke pasur një rezultat të mirë të indeksit të pasurisë (Spearman's rho=.238, $p<0.001$).



Diskutimet në fokus grupe treguan një histori tjetër. Disa nga pjesëmarrësit në fokus grupe deklaruan se disa nga shokët e tyre kanë filluar të konsumojnë drogë që nga moshën 15 vjeçare. Shumica ndikohen në rrjetet sociale, internet dhe artistët reperë që e promovojnë. Arsye të tjera të rëndësishme janë të qenit "IN" dhe kurioziteti. Pjesëmarrësit pohojnë se ekziston një perceptim se nëse dikush nuk e përdorë, ai/ajo të paktën e ka provuar njëherë. "Një shoqja ime pi ndonjëherë marijuanë. Ajo u çudit kur i thashë që nuk e kam provuar asnjëherë. Vazhdonte të thoshte se është e pamundur, të gjithë po e provojnë dhe është normale. Ajo nuk beson se mund të bëhet e varur." (Poudujevë, femër, 25 vjeç).

Ndërsa kur cigarja filloi të mos ishte më në "modë", të rinjtë filluan të përdorin drogë. "Ata ishin të vetëdijshëm se është shumë e lehtë për ta blerë. Nuk është shumë e shtrenjtë, nuk e konsumojnë shpesh kështu që mbledhin paratë për ta blerë dhe pirë së bashku. Mendojnë se nuk krijon varësi" (Prishtinë, Meshkuj, 23 vjeç).

"Më kujtohet kur motra ime ishte në shkollë të mesme dhe unë isha e vogël, dëgjuam një rast të një shokut të saj që përdorte drogë. Ishte një problem i madh në atë kohë. Tani, kur jam në shkollë të mesme dhe tregoj histori për pothuajse të gjithë shokët që përdorin drogë, është bërë bisedë normale dhe asnjë nuk çuditet. Po bëhet e pranueshme në shoqëri" (Mitrovicë, femër, 18 vjeçare).

JETA SEKSUALE

Lidhur me sjelljen seksuale të të rinjve, 19 për qind e tyre nuk u përgjigjën ose nuk u ndjenë rehat për t'u përgjigjur. Kjo shifër është akoma më e ulët sesa në të njëjtat studime që janë organizuar në Bosnje Hercegovinë (48.8 për qind) dhe Maqedoni (37 për qind). Nga ana tjetër, vetëm 46.2 për qind e të rinjve konfirmojnë se nuk kanë kryer marrëdhënie seksuale.


Natyrisht, personat 25–29 vjeç kanë më shumë përvojë seksuale, krahasuar me të rinjtë në vitet e adoleshencës. Përvoja seksuale është më mbizotëruese tek meshkujt sesa femrat (Spearman's rho=.347, $p<0.001$). Për më tepër, aktiviteti seksual lidhet me rezultatin e indeksit të pasurisë, pasi rinia që i korrespondon familjeve në një gjendje më të mirë ekonomike priren të deklarojnë më shumë për një sjellje të tillë (Spearman's rho=.207, $p<0.001$).

Kontraktivët përdoren nga 40 për qind e të rinjve që kanë pasur eksperiencë seksuale. Katër për qind e të rinjve nuk janë të informuar mbi këto çështje. Ekziston një lidhje statistikiqisht shumë e rëndësishme ndërmjet atyre që pinë alkool dhe të rinjve që përdorin kontraktivë (Spearman's rho=.355, $p<0.001$). Për më tepër, ata që janë në rezultatin e indeksit të pasurisë si "të pasur" dhe kanë përfunduar nivele të larta të arsimit janë më të prirur për të përdorur kontraktivë (Spearman's rho=.239, $p<0.001$, Spearman's rho=.274, $p<0.001$). Meshkujt janë të mësuar me kontraktivët (Spearman's rho=.196, $p<0.001$), ndërsa rezidenca urbane apo rurale nuk jep ndonjë dallim statistikor lidhur me këtë.


Për sa i përket sjelljeve të të anketuarve lidhur me dëshirat seksuale, duhet të përmendet se virgjëria është çështje dinjiteti për të dy gjinitë; kjo është çfarë besojnë 37 për qind të të anketuarve. 23 për qind theksojnë se është çështje dinjiteti, sidomos për vajzat.

Nga ana tjetër, rreth një e katërta e të rinjve nuk u përgjigjën apo nuk dinin si t'i përgjigjeshin kësaj pyetje. Nuk ka ndonjë ndryshim të rëndësishëm statistikor ndërmjet femrave dhe meshkujve, ndërsa të rinjtë në zonat rurale janë më konservatorë për virgjërinë (Spearman's rho=-.070, $p=0.048$). Për më tepër, të rinjtë që marrin pjesë shpesh në shërbime fetare janë më të prirur të mendojnë për moskryerje të marrëdhënieve seksuale përpara martesës (Spearman's rho=-.128, $p<0.001$).


DIAGRAMI 5.8: **Përvoja seksuale**



DIAGRAMI 5.9: **Sjellja ndaj përdorimit të kontraceptivëve**



DIAGRAMI 5.10: **Mendimi për virgjërinë deri në martesë**



DISKUTIM

Shumica e të rinjve në Kosovë jetojnë me prindërit e tyre dhe ndonjëherë edhe me gjyshërit, duke qenë në një mbikëqyrje të vazhdueshme dhe varësi financiare. Si rezultat, ata kanë zgjedhje të kufizuara në aspekte të kohës së lirë dhe mënyrës së jetesës, dhe është i habitshëm fakti që më shumë se 80 për qind e të rinjve duan të kalojnë kohën e lirë me familjet e tyre. Shumica e të rinjve janë ende në shkollë, disa prej tyre nuk janë në shkollë dhe janë të papunë, kështu që nuk mund ta shmangin kalimin e kohës me familjet e tyre, kështu që ata të cilët kanë dhënë këtë përgjigje e kalojnë kohën në mënyrë pasive dhe kanë rrjet të ngushtë shoqëror.

Dallimet ndërmjet të rinjve urbanë dhe ruralë janë më të mëdha në kontekstin e kohës së lirë dhe mënyrës së jetesës. Të rinjtë në zonat rurale nuk mund ta shmangin kalimin e kohës në mënyrë më pasive, për shkak të mungesës së vendeve të argëtimit apo institucioneve kulturore/sportive. Nga ana tjetër, konsumimi i alkoolit dhe duhanit është më i përhapur në zonat urbane.

Gjysma e të rinjve në Kosovë nuk kryejnë aktivitete seksuale, megjithëse aktiviteti rritet proporcionalisht me moshën. Përgjegësia për përdorimin e kontraceptivëve është më e lartë tek djemtë. Virgjëria është shumë e rëndësishme, veçanërisht për faktin se një e katërta e të rinjve mendojnë se është virtyt dhe duhet të ndiqet nga vajzat.



6

FAMILJA DHE SHOQËRIA

Në shoqërinë kosovare, familja konsiderohet tradicionalisht si një nga vlerat më të rëndësishme. Kjo është e dallueshme në gjetjet e pjesëve të mëparshme, lidhur me rëndësinë e familjes në disa aspekte. Familja në Kosovë është ende e fortë nuk ka pësuar transformime si në vendet e tjera. Kosova është një fortesë e pastër e familjes, ku përparësia e interesave familjare është shumë më e rëndësishme se interesat individuale. Moshë e martesës është akoma e ulët, numri i fëmijëve të dëshiruar është ende i lartë dhe zakoni i të jetuarit me prindërit është ende i lartë dhe pak të rinj jetojnë larg prindërve të tyre.

GJETJET KRYESORE

- Të rinjtë kosovarë jetojnë në familje shumë të mëdha. Numri mesatar i anëtarëve të familjes të të anketuarit është 5.7 anëtarë. Familjet e mëdha priren të jenë më të varfra sesa familjet më të vogla, me një nivel më të ulët arsimimi për të rinjtë. Për më tepër, sa më i lartë të jetë niveli i arsimit të nënës së të anketuarve, aq më të vogla janë familjet.
 - Shumica e të rinjve (80 për qind) jetojnë akoma me anëtarët e afërt të familjes dhe një tjetër 8 për qind jetojnë në apartamente/shtëpi të trashëguara të blera nga prindërit e tyre. Nga ata të cilët jetojnë me prindërit, rreth 83 për qind e të rinjve të moshave 24–29 vjeç preferojnë të jetojnë me prindërit pasi është zgjidhja më e thjeshtë dhe e rehatshme.
 - Pothuajse të gjithë të rinjtë e pyetur (98 për qind) thanë se kishin një marrëdhënie të mirë me prindërit, ku dy të tretat thanë se ishin në një marrëdhënie shumë të mirë dhe një e treta kanë marrëdhënie të mira përkundër disa dallimeve në opinione. Kjo konfirmon një pozicion shumë të qëndrueshëm të familjes në listën e vlerave të të rinjve në Kosovë.
 - Një e katërta e të rinjve do t'i rriste ndryshe fëmijët e tyre në krahasim me prindërit e tyre. Nga ana tjetër, vetëm 30 për qind e tyre do t'i rrisnin fëmijët në të njëjtën mënyrë. Të rinjtë që jetojnë në familje me kushte më të mira ekonomike dhe që kanë nënë me nivel më të lartë arsimimi kanë më shumë mundësi për t'i rritur fëmijët e tyre në të njëjtën mënyrë.
 - Babai dhe nëna kanë një ndikim shumë të fortë në vendimet e rëndësishme të të rinjve në Kosovë. Pothuajse 60 për qind e të rinjve marrin vendimet e rëndësishme me prindërit e tyre. Meshkujt kanë një tendencë më të madhe për t'i marr vendimet vet, së bashku me të rinjtë e edukuar.
 - Ka një rritje të rëndësishme në moshën e preferuar për martesë për meshkujt, nga meshkujt dhe femrat, nga 26 në 29 vjeç. Për më tepër, të rinjtë preferojnë të kenë fëmijën e tyre të parë mesatarisht pas moshës 25 vjeç.
 - 54 për qind e të rinjve në Kosovë planifikojnë të kenë tre ose më shumë fëmijë. Nga ana tjetër, vetëm 1 për qind e numrit të të rinjve në Kosovë duan vetëm një fëmijë. Grupi më i ri në Kosovë në përgjithësi do një numër më të ulët të fëmijëve, ndërsa ata që janë pjesë e familjeve me gjendje më të mirë ekonomike duan një numër më të madh të fëmijëve.
 - Faktorët më të rëndësishëm që ndikojnë në zgjedhjen e bashkëshortit/bashkëshortes janë personaliteti, miratimi i familjes dhe besimi fetar. Miratimi i familjes në zgjedhjen e partnerit është shumë i rëndësishëm për femrat dhe për ata të cilët jetojnë në familje që kanë një gjendje të mirë ekonomike.
- Të rinjtë kosovarë jetojnë në familje shumë të mëdha. Numri mesatar i pjesëtarëve të familjes në familjet e të anketuarve është 5.7 pjesëtarë. Këto familje të mëdha janë përbërësi kryesor në transmetimin e vlerave të familjes nga brezat e vjetër në ato të rinj. Shpërndarja e anëtarëve të familjes në zonat rurale dhe urbane është shumë e ngjashme, me më shumë se një të katërtën e të

DIAGRAMI 6.1: **Sa persona jetojnë në familjen tuaj, përfshirë juve?**DIAGRAMI 6.2: **Mënyra e banimit të të rinjve në Kosovë**


rinjve që jetojnë në familje me 7 apo më shumë anëtarë. Ka vetëm disa familje më të vogla në zonat urbane, ku 13 për qind e të gjithë familjeve urbane të të rinjve kanë 2–3 anëtarë, krahasuar me 11 për qind të familjeve rurale. Në tërë mostrën nuk ka familje me një person. Zakonisht familjet konsistojnë nga tre breza, pasi në përgjithësi gjyshërit jetojnë me prindërit dhe fëmijët, duke ndarë përgjegjësinë e rritjes së fëmijëve. Për më tepër, familjet e mëdha janë të lidhura statistikisht me rezultatin, indeksin e pasurisë, gjuhën, arsimimin e të anketuarve dhe arsimimin e nënës së të anketuarit. Familjet më të mëdha priren të jenë më të varfra sesa familjet më të vogla në indeksin e pasurisë (Spearman's rho=-.153, p<0.001). Familjet që flasin shqip janë më të mëdha në numër. Sa më i lartë të jetë niveli i arsimit të të anketuarit (Spearman's rho=-.142, p<0.001) dhe nënës së të anketuarit (Spearman's rho=-.112, p<0.001), aq më e vogël është familja. Për më tepër, të rinjtë që jetojnë në familje më të mëdha, planifikojnë të kenë fëmijë në moshë më të re (Spearman's rho=-.84, p<0.001).

MARRËDHËNIET ME PRINDËRIT

Roli i prindërve është shumë i rëndësishëm për të rinjtë në Kosovë. Shumica, prej 81 për qind të të anketuarve kanë jetuar me prindërit në vitin e fundit dhe 8 për qind janë duke jetuar në apartamente/shtëpi të trashëguar apo apartamente/shtëpi të blerë nga prindërit e tyre. Edhe të rinjtë të moshës 24–29 vjeç në 63 për qind të rasteve jetojnë në shtëpinë e prindërve, që tregon se procesi i të jetuarit vetëm në përgjithësi merr shumë kohë. Vetëm 14 për qind do të dëshironin të jetonin vetëm por pengohen nga rrethanat financiare.


Marrëdhënia me prindërit mbetet shumë e fortë dhe ka qëndruar e njëjtë për të paktën gjashtë vitet e fundit, krahasuar me 2012 (W1 në grafik). 98 për qind e të rinjve në Kosovë konfirmojnë se në përgjithësi kanë një marrëdhënie të mirë me prindërit, duke përfshirë 35 për qind që pranojnë se kanë dallime në opinione. Kjo konfirmon një pozicion shumë të qëndrueshëm të familjes në listën e vlerave të të rinjve në Kosovë. Vetëm 1 për qind e të rinjve shprehën se kanë një marrëdhënie konfliktuale me prindërit e tyre. Ka

DIAGRAMI 6.3: Cila nga deklaratat më poshtë i përshkruan më së miri marrëdhëniet tuaja me prindërit?



shumë pak tregues që tregojnë një rëndësi statistikore me këtë aspekt, ndërsa gjinia, moshë dhe niveli arsimor nuk ndikojnë në këtë marrëdhënie. Të rinjtë që jetojnë në zona rurale priren të jenë në një marrëdhënie konfliktuale në familjet e tyre (Spearman's rho=-.180, $p<0.001$). Për më tepër, ata që nuk janë të kënaqur në përgjithësi me jetën e tyre, priren të kenë një marrëdhënie konfliktuale me prindërit e tyre (Spearman's rho=-.172, $p<0.001$), duke sugjeruar se të rinjtë kanë një qasje më individuale.

DIAGRAMI 6.4: A do t'i rrisnit fëmijët tuaj në të njëjtën mënyrë si ju kanë rritur prindërit juve, apo do vepronit ndryshe?



Megjithëse duket se të rinjtë shkojnë shumë mirë me prindërit, vetëm 30 për qind e tyre do t'i rrisnin fëmijët në të njëjtën mënyrë, dhe 41 për qind do t'i rrishte fëmijët pothuajse njësoj si prindërit e tyre. Një e katërta e të rinjve do t'i rrishte fëmijët e tyre ndryshe në krahasim me prindërit e tyre.

Ekzistojnë shumë pak tregues që tregojnë një domethënie statistikore për këtë aspekt. Të rinjtë që jetojnë në familje në gjendje të mirë ekonomike do t'i rrisnin fëmijët në të njëjtën mënyrë (Spearman's rho=.076, $p=0.011$). Pjesa e të rinjve të grupit më të madh në moshë në këtë anketë (24–29 vjeç) do të përiqeshin t'i

rrisnin fëmijët e tyre ndryshe (Spearman's rho=-.125, $p=0.011$). Nga ana tjetër, sa më i lartë të jetë niveli i arsimimit të nënës si prind, aq më të mëdha janë shanset për të pasur një shembull të mirë për brezin e ardhshëm (Spearman's rho=.119, $p<0.001$).

SI MARRIN VENDIME TË RINJTË?

Të rinjtë u pyetën se cili nga pjesëtarët e familjes ka më shumë ndikim në vendimet që ata marrin për gjëra të rëndësishme në jetë, duke përfshirë veten e tyre. Të dy prindërit kishin një ndikim shumë të madh në vendime të rëndësishme. Struktura patriarke e familjes duket se ka një orientim drejt një parimi më kolegjal në vendimmarrje pasi 58 për qind zgjodhën babanë, ndërsa gjysma e të rinjve përmendin nënën.


Në varësi të gjinisë, moshës dhe vendbanimit të të anketuarve, përgjigjja e kësaj pyetje ndryshon. Femrat kanë një ndikim më të madh nga të dy prindërit, ndërsa meshkujt ndikohen më shumë nga etërit (Spearman's rho=.209, $p<0.001$).

Në përgjithësi, 26 për qind e të anketuarve duken se janë të pavarur, që do të thotë se janë të lirë në procesin vendimmarrës. Ka një ngritje të lehtë me 4 për qind krahasuar me vitin 2012. Rreth 60 për qind e të rinjve marrin vendimet e rëndësishme me prindërit. Meshkujt kanë prirje më të madhe për t'i marrë vetë vendimet (Spearman's rho=.092, $p=0.003$), ndërsa ka një rritje të dukshme të femrave që thonë të njëjtën gjë krahasuar 2012 me 2018 (nga 17 për qind në 23 për qind). Të rinjtë e edukuar (Spearman's rho=.325, $p<0.001$), ata në familje me kushte më të mira ekonomike (Spearman's rho=.121, $p<0.001$) dhe më të mëdhenjtë (Spearman's rho=.412, $p<0.001$), kanë norma shumë më të larta të pavarësisë në vendimmarrje.


PLANIFIKIMI FAMILJAR

Të rinjtë e Kosovës janë shumë të vendosur dhe unanimit në mënyrën se si e parashikojnë të ardhmen e familjes së tyre, pasi 89 për qind e të anketuarve zgjodhën opsionin "martesë me fëmijë". Në këtë rast, si martesë zyrtare dhe fëmijët janë të rëndësishëm, por martesë jozyrtare me fëmijë mbështetet nga 5 për qind e të rinjve si një plan familjar i mundshëm. Planet për një


DIAGRAMI 6.5: **Kush nga anëtarët e familjes suaj ose të afërmit ndikon më së shumti në vendimet tuaja të rëndësishme?**



DIAGRAMI 6.6: **Cila nga deklaratat më poshtë e përshkruan më së miri gjendjen tuaj?**



DIAGRAMI 6.7: **Planifikimi familjar**



familje pa fëmijë, apo beqar me ose pa fëmijë kanë një mbështetje minimale të më pak se 3 për qind.

Mosha për martesë


Ka një rritje të rëndësishme në moshën e preferuar për martesë për djemtë, si nga meshkujt dhe femrat, për të paktën dy vjet krahasuar me studimin e mëparshëm të rinisë në vitin 2012. Djemtë preferojnë një moshë më të ulët për martesë për meshkujt dhe femrat. Vajzat preferojnë mesatarisht moshën 26 vjeçe për veten e tyre dhe 29 për meshkujt.

TABELA 4: **Mosha e përshtatshme për martesë**

| Mosha e duhur për martesë për femrat | | |
|--------------------------------------|------|------|
| | 2012 | 2018 |
| Meshkuj | 23 | 25 |
| Femra | 24 | 26 |

| Mosha e duhur për martesë për meshkuj | | |
|---------------------------------------|------|------|
| | 2012 | 2018 |
| Meshkuj | 26 | 28 |
| Femra | 27 | 29 |

Të pyetur për moshën kur të rinjtë duan të kenë fëmijën e tyre të parë, femrat duan të kenë fëmijën e tyre të parë mesatarisht në moshën 25 vjeçare, ndërsa meshkujt duan të bëhen baba në moshën 27 vjeçare.



Të rinjtë në zonat rurale (Spearman’s rho=-.093) dhe të rinjtë që në përgjithësi janë të kënaqur me jetën e tyre (Spearman’s rho=-.076, p=0.045) duan të kenë fëmijën e tyre të parë në një moshë të re. Të rinjtë që vijnë nga familje në një gjendje më të mirë ekonomike (Spearman’s rho=.164, p<0.001), dhe që kanë prindër me nivele të larta arsimimi (Spearman’s rho=.192, p<0.001) në përgjithësi janë duke planifikuar të kenë fëmijën e tyre të parë në një moshë më të lartë se mesatarja.


Nga diskutimet e fokus grupeve doli fakti se perceptimi për martesën ka ndryshuar. Disa vite më parë, mosha e duhur për t’u martuar ishte 18–19 vjeç dhe tani është rreth 27. *“Më përpara, për shkak të mentalitetit, na është thënë se duhet të martohemi të reja në moshën 18 vjeçare. Aktualisht, prindërit nuk na nxisin të martohemi kështu që mund të presim derisa të gjejmë partnerin e duhur”.* (Prishtinë, femër, 23 vjeç).

Megjithëse të rinjtë planifikojnë të martohen dhe të kenë fëmijën e parë pas moshës 25 vjeçare, duan një numër të madh fëmijësh. Rezultatet tregojnë se të rinjtë kosovarë duan familje të mëdha dhe nuk duan ta ndryshojnë shumë situatën aktuale. Për më tepër, rezultatet tregojnë disa shifra të veçanta. Vetëm një për qind

e të rinjve në Kosovë duan vetëm një fëmijë. Nga ana tjetër, 22 për qind e të rinjve nuk dinë se sa fëmijë duan të kenë, ose nuk duan t’i përgjigjen kësaj pyetje. Pavarësisht se kanë një përqindje më të lartë pa përgjigje nga më të rinjtë, të tjerët duket se kanë një mendim konfuz mbi këtë çështje. Në 2012, rreth 59 për qind e të rinjve në Kosovë planifikonin të kishin tre ose më shumë fëmijë. Në 2018, rreth 54 për qind duan tre ose më shumë fëmijë (grafiku përfshin edhe ata që nuk iu përgjigjën kësaj pyetje, duke rezultuar në një shifër më të vogël prej 41 për qind). Grupmosha më e re (Spearman’s rho=.120, p<0.001) dhe femrat në përgjithësi duan një numër më të vogël fëmijësh (Spearman’s rho=-.077, p=0.024). Për më tepër, ata që janë pjesë e familjeve me gjendje më të mirë ekonomike, në përgjithësi duan më shumë fëmijë (Spearman’s rho=.090, p=0.090).

Faktorët më të rëndësishëm që kontribuojnë në zgjedhjen e bashkëshortit/bashkëshortes në formimin e familjes janë si në vijim: personaliteti (78 për qind), miratimi i familjes (68 për qind), besimi fetare (65 për qind), interesi i përbashkët (64 për qind) dhe virgjëria (62 për qind). Faktorë më pak të rëndësishëm përfshijnë pamja e jashtme (30 për qind), gjendja ekonomike (29 për qind) dhe origjina kombëtare (28 për qind).

Të rinjtë e Kosovës konfirmojnë rolin e familjes edhe në marrjen e vendimeve personale si martesë. Miratimi i familjes në zgjedhjen e partnerit është i rëndësishëm në 68 për qind të rasteve. Ka një lidhje statistikisht të rëndësishme ndërmjet marrjes së miratimit nga familja dhe faktorëve të tjerë. Ata të cilët do t’i rrisnin fëmijët në të njëjtën mënyrë si prindërit i rritën ata, janë më të prirë për të marrë miratimin e familjes përpara martesës (Spearman’s rho=.169, p<0.001). Për më tepër, femrat janë më të varura në marrjen e miratimit nga familja krahasuar me meshkujt (Spearman’s rho=-.153, p<0.001). Ata të cilët jetojnë në familje që nuk janë në gjendje të mirë ekonomike janë më të ndikuar për të marrë miratimit e familjes përpara martesës (Spearman’s rho=-.082, p=0.007). Sa më të rinj të jenë, aq më shumë mendojnë se duhet të marrin miratimin nga familja përpara se të zgjedhin bashkëshortin/bashkëshorten (Spearman’s rho=-.120, p<0.001).



56 për qind e të rinjve në Kosovë konsiderojnë nivelin e arsimit si një element shumë të rëndësishëm në zgjedhjen e partnerit. Femrat janë më të interesuara në nivelin e arsimit të partnerit krahasuar me meshkujt (Spearman's $\rho = -.113$, $p < 0.001$). Është interesante që të rinjtë pjesë e familjeve në kushte më të mira ekonomike janë më të prirë për të gjetur partner më një nivel më të mirë arsimor (Spearman's $\rho = 0.084$, $p = 0.005$). Sa më të rinj të jenë, aq më shumë mendojnë se niveli i arsimit ka ndikim në vendimin e tyre për të zgjedhur një partner martesë (Spearman's $\rho = -.183$, $p < 0.001$). Lidhja më e habitshme është fakti se sa më i lartë të jetë niveli i arsimit të baballarëve, aq më i rëndësishëm bëhet niveli i arsimit në zgjedhjen e partnerit (Spearman's $\rho = .140$, $p < 0.001$).

Në zgjedhjen e partnerit, femrat priren t'i kushtojnë më shumë vëmendje miratimit nga familja, gjendjes ekonomike dhe personalitetit, ndërsa meshkujt i kushtojnë më shumë rëndësi pamjes, virgjërisë dhe besimit fetar.

DISKUTIM

Familja konsiderohet si vlera më e rëndësishme në Kosovë. Studiimi zbuloi ruajtjen e fortë të karakteristikave tradicionale të familjes kosovare, si dhe tendencat e dobëta për të modifikuar disa aspekte specifike. Familjet kosovare janë akoma të mëdha në numër dhe është e lehtë për të transferuar vlerat tradicionale të familjeve nga brezi i vjetër në atë të ri. Prindërit kujdesen për strehimin dhe çështjet ekonomike të fëmijëve. Ndonjëherë prindërit i gjejnë punë të rinjve, ose ndikojnë në rezultateve e tyre në shkollë. Të gjithë këto faktorë çojnë në një varësi të fortë të të rinjve në lidhje me prindërit e tyre. Nevoja për të qenë të pavarur dhe për të jetuar veçmas rritet shumë vonë me moshën, dhe të rinjtë janë të ngadaltë për të qenë të shqetësuar se duhet të sigurojnë jetesën me shpenzimet e tyre.

Në përgjithësi, ekziston një dallim i madh gjinor në strukturën tradicionale të familjeve kosovare. Mbikëqyrja dhe vendimmarrja e familjes janë më të zakonshme për vajzat sesa djemtë. Sikurse u përmend më lart, femrat janë më të varura nga marrja e miratimit nga familja për zgjedhjen e partnerit për martesë. Zakonisht femrat marrin vendime së bashku me prindërit e tyre, ndërsa meshkujt janë më të pavarur në vendimmarrje. Ndryshimi më i rëndësishëm në këtë aspekt është se femrat nuk nxiten për t'u martuar në një moshë të re, duke marrë më shumë kohë në zgjedhjen e partnerit për martesë.

Për të rinjtë, hapësira themelore fillon nga familja e prindërve dhe përfundon në familjen e tyre. Megjithëse mbikëqyrja e parë shoqërore e të rinjve kryhet nga vet familja, të rinjtë nuk e venë në diskutim asnjëherë familjen dhe shprehin vetëm besim në anëtarët e familjes. Për më tepër, presin që të përfundojnë arsimin dhe të gjejnë punë nëpërmjet mbështetjes familjare, dhe vet familja shërben si zëvendësues për hapësirën sociale që të rinjtë duhet të kenë në botën e jashtme.

Nga ana tjetër, fakti se vetëm 30 për qind e të rinjve do t'i rrisnin fëmijët e tyre në mënyrën se si ishin rritur nga prindërit e tyre, tregon se një pjesë e rinisë ka nisur të mendojnë përtej traditave dhe normave me të cilat janë rritur.

Në përfundim, paradigma e familjes tradicionale kosovare është ende shumë e rëndësishme për të rinjtë. Të gjithë mekanizmat joformalë shoqërorë janë ende të lidhur me traditat dhe politikat e realizuara nga qeveria duhet të kenë në vëmendje individin, në vend të familjeve. Vlerat që lidhen me zhvillimin personal, individualizmin dhe pavarësinë janë elementët kryesorë për një shoqëri dhe ekonomi të zhvilluar, prandaj nevojitet një transmetim i ri i këtyre vlerave të reja në mënyrë që të rinjtë e Kosovës të kenë individualizmin e nevojshëm për të qenë ambicioz në jetë dhe për të kërkuar suksesin jashtë familjes.

7

ARSIMIMI

Vitin e kaluar, Kosova shpenzoi rreth 4.3 për qind të PBB-së për arsimin (duke përfshirë arsimin e lartë), megjithatë pothuajse 60 për qind e këtyre shpenzimeve iu kushtuan rrogave të mësuesve në arsimin fillor. Në 2014–2015, pothuajse 110,000 studentë ishin të regjistruar në institucionet e arsimit të lartë, kryesisht në institucione publike, megjithëse rreth 35 për qind e studentëve janë regjistruar në 29 institucione private të arsimit të lartë të akredituara nga Agjencia e Akreditimit në Kosovë. Megjithëse Kosova nuk i është bashkuar zyrtarisht Procesit të Bolonjës, zbatimi i saj është trendi kryesor në politikat e arsimit të lartë.

Arsimi pritet që të sigurojë shkathtësitë dhe aftësitë e nevojshme për punësim, dhe arritjen e një standardi të përshtatshëm jetese, në vend dhe jashtë vendit. Kosova ndjek trendin global të rritjes së shpejtë të të rinjve që hyjnë në sistemin e arsimit të lartë (GoK, 2016). Për më tepër, arsimi zë një pjesë të konsiderueshme në jetët e të rinjve në shoqërinë kosovare, dhe mund të ndikojë në përmbushjen dhe zhvillimin personal dhe profesional të tyre. Një arsye tjetër e nivelit të lartë të regjistrimit në arsim mund të jetë një përpjekje e disa vendeve në tranzicion për të “lehtësuar presionin e punësimit dhe ulur papunësinë e të rinjve”¹. Kjo ndodh edhe në Kosovë, ku shumica absolute 92 për qind e të rinjve kosovarë synojnë të ndjekin arsimin e lartë.


Sektori i arsimit nuk është i përshtatur në mënyrën e duhur me nevojat e tregut të punës, duke rezultuar në punësim të ulët të të diplomuarve dhe një premium të rëndësishëm të aftësive. Shpenzimet publike në arsim mbetën të pandryshuara me 4.6 për qind të PBB-së në 2016, që është në përgjithësi në linjë me vendet e tjera me të ardhura mesatare me profile të ngjashëm të moshës. Megjithatë, duke konsideruar numrin relativisht të lartë të studentëve, Kosova shpenzon më pak se vendet fqinje për studentë në arsimin fillor. Për më tepër, shpenzimet për arsimin mbizotërojnë nga pagat. Normat e regjistrimit në kujdesin e hershëm të fëmijëve dhe parashkollorë janë shumë të ulëta respektivisht 4,4 për qind dhe 33,9 për qind, me poshtë se qëllimi i BE-së me 95 për qind deri në 2020. Në kontrast ka një nivel të lartë regjistrimi në arsimin fillor dhe sekondar, respektivisht 96 për qind dhe 88,1 për qind.

Regjistrimi në nivelin e tretë është shumë i lartë me 120,000 studentë në institucionet e arsimit të lartë publik dhe privat. Megjithatë rezultatet e ulëta në testin PISA dhe një nivel i lartë papunësie në të diplomuarit me arsim të lartë (26,3 për qind në Q3 2017) tregojnë një cilësi të ulët të arsimit në përgjithësi dhe mos-përputhje të tij me nevojat e tregut të punës. Duke qenë në këtë situatë, Kosova duhet të punojë në zhvillimin e një bashkëpunimi më të ngushtë ndërmjet sistemit arsimor dhe sektorit privat (Komisioni Evropian, 2018).

GJETJET KRYESORE

- Të rinjtë kryesisht nuk janë të kënaqur me cilësinë e arsimit në Kosovë. Vetëm 23 për qind mund të konsiderohen të kënaqur me cilësinë e arsimit dhe kjo është një nga shifrat më të ulëta në rajon. Për më tepër, Kosova është i vetmi vend që ka një përqendrim në nivelin e kënaqësisë me cilësinë e arsimit. Të rinjtë më të rinj dhe femrat duken më të kënaqur me cilësinë e arsimit.
- Më shumë se 56 për qind e të rinjve pranojnë se ka raste të dhënies së rryshfetit në institucionet/universitetet në Kosovë. Ky fenomen është më i përhapur në zonat urbane.
- Shumica e të rinjve që ndjekin shkollën në Kosovë shpenzojnë të paktën 2 orë në ditë duke studiuar. Ka një rritje të lehtë në numrin e nxënësve dhe studentëve që studiojnë për më tepër se dy orë në ditë. Ka një numër të konsiderueshëm më të madh orësh studimi për studentët në universitetet në krahasim me grupet e tjera. Kjo tregon se shkollat e mesme perceptohen më pak kërkuese se universitetet.
- Ka një ulje të nivelit të stresit në shkolla/universitetet në vitet e fundit. Niveli i studentëve që raportojnë se jeta në shkollë është “e vështirë dhe stresuese” dhe “shumë e vështirë dhe stresuese” ka rënë nga 30 për qind në 13 për qind. Nga ana tjetër, studentët në nivelin e lartë arsimor tregojnë se kalojnë një kohë më stresuese se homologët e tyre në shkolla të mesme.

DIAGRAMI 7.1: Sa jeni të kënaqur në përgjithësi me cilësinë e arsimit në vendin tuaj?



— Vetëm 28 për qind e të rinjve kanë marrë pjesë në praktika apo stazhe, megjithëse niveli i pjesëmarrësve në praktika është rritur ndjeshëm në universitete.

Kënaqshmëria me cilësinë e arsimit në Kosovë ka sjellë disa rezultate të përziera, duke treguar një nivel të ulët të kënaqësisë me cilësinë e arsimit.


Vetëm 23 për qind e të rinjve në Kosovë konsiderohen të kënaqur me cilësinë e arsimit. Kjo është një nga shifrat më të ulëta në të gjithë studimet e Rinisë në Evropën Lindore (YSEE), përveç Maqedonisë.

Për më tepër, Kosova është i vetmi vend në rajon që ka një përqendrim të lehtë në të kënaqurit me cilësinë e arsimit, krahasuar me rezultatet e 2012 dhe 2018.

Është shumë e qartë se nëngrupi më i vjetër (24–29 vjeç) i të rinjve është më shumë i pakënaqur me këtë aspekt, ndërsa segmenti më i ri (14–17 vjeç) ka konsiderata më pozitive. Kjo konfirmohet edhe nga lidhjet statistikore (Spearman’s rho=-.130, p<0.001). E njëjta ndodh me grupin e femrave të cilat janë më të pakënaqura në 27 për qind të rasteve, ndërsa meshkujt janë të pakënaqur në 32 për qind të rasteve.

Studentët aktualë në universitete janë qartësisht më pak të kënaqur me sistemin e arsimit në krahasim me nxënësit e shkollës së mesme. Nxënësit e shkollave të mesme kanë një nivel më të lartë kënaqësie. (Spearman’s rho=-.096, p=0.013)


DIAGRAMI 7.2: Kënaqësia me nivelin e arsimit



“BLERJA” E NOTAVE

Rinia ka perceptimin se “blerja” e provimeve është e zakonshme. Më shumë se 56 për qind e të anketuarve pranojnë se ka raste kur provimet blihen. Kjo është më e pranishme në zonat urbane krahasuar me zonat rurale (Cramer’s V=.135). Problemi bëhet më evident në ata që kanë përfunduar ciklin e tretë të studimeve (studime universitare).

DIAGRAMI 7.3: **A pajtoheni se ka raste kur notat dhe provimet ,blihen’ në institutet/universitetet në Kosovë?**



Nga ana tjetër, diskutimet në fokus grupe zbuluan se ka shumë mënyra për të kaluar një provim, nga dhënia e parave deri në rastet e ndikimit nga rrethi familjar apo shoqëror. Të gjithë kanë përjetuar këtë fenomen. *“Nëse prindërit e një studenti punojnë në fushën e mjekësisë, dhe djali apo vajza janë duke studiuar në të njëjtën fushë, është e sigurt se do t’i kalojnë provimet duke përdorur ndikimin e tyre”.* (Prishtinë, Meshkuj, 26 vjeç)


SA ORË NË DITË STUDIOJNË TË RINJTË?

Shumica e të rinjve në Kosovë shpenzojnë të paktën dy orë në ditë duke studiuar. Ka një rritje të lehtë në numrin e nxënësve dhe studentëve që studiojnë më shumë se dy orë në ditë në 2018, në total rreth 54 për qind të numrit total të të rinjve. Lidhur me nivelin e arsimit, ka një numër dukshëm më të lartë të orëve të studimit për studentë universiteti dhe për femra, krahasuar me grupet homologe. Orët e studimit janë të lidhura negativisht me jetën e përditshme jo stresuese në shkolla/ universitete. Kjo do të thotë se orët më të gjata të studimit i sjellin studentëve më shumë stres dhe e kundërta (Spearman’s rho=-.172, p<0.001). Në të njëjtën kohë vajzat janë më të prirura për të studiuar orë më të gjata krahasuar me djemtë dhe koeficienti statistikor është shumë i lartë për këtë lidhje (Spearman’s rho=-.272, p<.001).


Nga ana tjetër, sa më i lartë të jetë niveli i studimeve (bachelor dhe më lart), aq më i lartë duhet të jetë numri i orëve që studentët duhet të studiojnë. Kjo tregon se shkolla e mesme perceptohet si më pak kërkuese se universiteti (Spearman’s rho=.125, p=0.001)

Ka një ulje të konsiderueshme në **nivelin e stresit të shkollave/universiteteve** në vitet e fundit. Pjesa e studentëve që raportojnë se jeta në shkollë është “e vështirë dhe stresuese” dhe “shumë e vështirë dhe stresuese” ka rënë nga 30 për qind në 13 për qind. Studentët që kanë nota më të mira tregojnë një nivel më të ulët stresi (Spearman’s rho=.171, p<0.001). Nga ana tjetër, studentët në nivel më të lartë arsimit duket se kalojnë një kohë më stresuese se homologët në shkolla të mesme. (Spearman’s rho=-.132, p=0.001).


DIAGRAMI 7.4: **Sa orë në ditë mesatarisht i kaloni duke studiuar (pas orëve të mësimit / në shtëpi)?**



DIAGRAMI 7.5: Niveli i stresit në 2012 (vala 1) dhe 2018 (vala 2)



DIAGRAMI 7.6: Pjesëmarrja në praktika



ORIENTIMI PRAKTIK I ARSIMIMIT DHE TRANZICIONI NË TREGUN E PUNËS

Është e qartë se studentët në arsimin e lartë kanë një nivel më të lartë pjesëmarrje në stazhe dhe praktike. Kjo lidhet më shumë me orientimin e sistemit arsimor.

Në përgjithësi, vetëm 28 për qind e të rinjve ka marrë pjesë në praktikë apo stazhe. Për më tepër, ne i pyetëm ata që ishin duke studiuar (në ciklin e dytë apo të tretë) për optimizimin e tyre në lidhje me mundësinë për të gjetur një punë pas diplomimit.

Nuk ekziston asnjë lidhje ndërmjet mundësisë së gjetjes së një vendi pune dhe orientimit praktik të arsimimit.

Shumica e pjesëmarrësve në fokus grupe pranuan se nuk ka lidhje ndërmjet arsimimit dhe tregut të punës. Është e vështirë në gjuhë një punë në fushën e studimit. *“Në universitete mësohet vetëm teoria, por jo aftësitë praktike në të njëjtën fushë. Disa kanë bërë praktika që i kanë gjetur vetë, por jo lidhur me fushën e studimit” (Prishtinë, femër, 25 vjeç)*

DISKUTIMI PËR ARSIMIN

Të rinjtë në Kosovë e vlerësojnë sistemin arsimor si jo të kënaqshëm, dhe institucionet arsimore nuk po e pajisin rininë me aftësitë e përshtatshme dhe “know-how”-un që do të përdoret në tregun e punës. Kjo mund të jetë pjesërisht shkak i kurrikulave të vjetra të institucioneve të arsimit të lartë që nuk lidhen me komponentët praktikë të tregut të punës.

Kurrikula arsimore është një problem i madh, pasi përmbajtja është e vjetruar dhe jo praktike. Edhe nëse do të kishte vende pune në tregun e punës, është e vështirë të llogaritet nëse aftësitë e ofruara në sistemin arsimor përbushin kërkesat e tregut të punës modern dhe institucional.

8

PUNËSIMI

Papunësia e të rinjve është një problem i madh në Kosovë. Sipas UNDP (2017), papunësia e të rinjve në Kosovë është 57,7 për qind. Shkalla e varfërisë kombëtare shtrihet për pothuajse një të tretën e popullsisë (29,7 për qind). Ky problem vjen nga ndërprerjet e shkaktuara nga fundi i regjimit komunist, lufta e vazhdueshme për pavarësi dhe ekonomia që është e varur nga ndihma financiare nga jashtë vendit. Megjithatë, Kosova është një nga kombet më të reja në botë dhe aktualisht në një pikë kritike. Vendi paraqet potencial të lartë për shkak të popullsisë së re që do të punojë dhe që mund të zhvillojë në mënyrë të rëndësishme ekonominë dhe tregun e punës nëse zhvillohen në mënyrën e duhur. (UNDP, 2017).²

Në të njëjtën kohë, shkalla e papunësisë u rrit nga 30,4 për qind krahasuar me 27,5 për qind në 2016 dhe Kosova ka ende shkallën më të lartë të papunësisë dhe pjesëmarrjes në Evropë. Papunësia e lartë e të rinjve (51,6 për qind) tregon për një mospërputhje të qartë ndërmjet sistemit arsimor dhe nevojave të tregut të punës (p.sh mospërputhje ndërmjet kualifikimeve dhe aftësive të studentëve dhe çfarë nevojitet në tregun e punës). Kjo kërkon politika më aktive të tregut të punës, skema para-kualifikimi dhe programe të kualifikimit profesional në sistemin arsimor (Komisioni Evropian, 2018).

Për më tepër, shkalla e papunësisë për personat nën 25 vjeç tregon një diferencë të madhe gjinore, dhe se vajzat e reja kanë një lidhje më të dobët në tregun e punës. Papunësia e vajzave të reja në Kosovë është 67 për qind, një model i ngjashëm vetëm me Bosnjë dhe Hercegovinën dhe Serbinë. Nga ana tjetër, papunësia e rinisë ka rënë për më të aftit, krahasuar 2016 me 2010, ndërsa të rinjtë më pak të aftë u përballën me numër në rritje të papunësisë (WB & WIW, 2017).

Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale përfundoi një draft të Planit të Veprimit mbi Punësimin e Rinisë dhe u miratua nga Qeveria më 4 Janar 2018. Kjo masë ka për qëllim të arrijë funksionimin e plotë të Agjencisë së Punësimin, të ofrojë shërbime cilësore për kalimin nga praktika profesionale në punësim, dhe të shtrijë masat aktive të tregut të punës të fokusuar mbi rininë, gratë dhe promovimin e sipërmarrjes (GoK, 2018)

Në raportin e saj, Cojocar u vendos rekomandimin specifik që mund të sjellë përmirësime lidhur me papunësinë dhe të krijojë një rini aktive, të punësuar që mund të gjejë punë që i përshtatet aftësive të tyre. Për më tepër, duke vënë në fokus aftësitë e nevojshme, si më lart, përmirësimi i shërbimeve publike si dhe reformat në sistemin e kujdesit social për të moshuarit dhe fëmijët mund të rrisin përfshirjen e grave në tregun e punës (Cojocar, 2017).

Në 2017 Kosova ishte një ndër 10 reformuesit më të mëdhenj sipas raportit të Bankës Botërore të Bërit Biznes. Megjithatë, pengesat kryesore për të bërë biznes përfshijnë një administratë të dobët dhe të papërgjegjshme, sundim të dobët të ligjit, korrupsion dhe një ekonomi informale të përhapur. Po ashtu informaliteti mbetet i lartë, rreth 30 për qind të PBB³.

Lidhur me politikën e punësimin, qeveria miratoi Strategjinë Sektoriale 2018–2022. Në përputhje me angazhimet e marra sipas Agjendës së Reformës Evropiane, qeveria zhvilloi një plan veprimi për të trajtuar papunësinë e rinisë. Buxheti i caktuar për masat aktive të tregut të punës mbetet i pamjaftueshëm. Shërbimet e punësimin publik kanë përmirësuar performancën në bashkimin e punëdhënësve me punëmarrësit.

GJETJET KRYESORE

- Kosova ka një nivel të lartë prej 25 për qind të NEET (të rinjtë që nuk arsimohen apo trajnohen). Pabarazia gjinore në statusin social është shumë e lartë. Femrat kanë nivele të lartë NEET dhe arsimimi, ndërsa meshkujt janë më prezentë në tregun e punës. Papunësia është më e përhapur ndër të rinjtë me prindër të një niveli të ulët arsimor, që vijnë nga familje të varfra dhe në përgjithësi nga zona rurale.
- Perceptimi mbizotëruar është se njohjet dhe lidhjet me njerëz në pushtet tregojnë pozicionin e individit në strukturën shoqërore dhe konsiderohet si faktor shumë i rëndësishëm për të gjetur një punë në 54–59 për qind të rasteve. Për më tepër, arsimit dhe përvoja e punës kanë të njëjtin ndikim.


- Të rinjtë në Kosovë shpesh janë të aftë (54 për qind e tyre) për të punuar punë brenda profesionit të tyre. Kjo tregon një mospërputhje të lartë ndërmjet kualifikimeve të forcës së punës dhe nevojave dhe kërkesave të tregut për fuqi punëtore. Femrat duket se kanë prirje më të lartë për të punuar në profesionin e tyre.
- Mbi arsimimi është një dimension i rëndësishëm i mospërputhjes së aftësive të larta. Rreth 44 për qind e punëve aktualisht në Kosovë për të rinjtë kërkojnë një nivel më të ulët formimi arsimor krahasuar me nivelin ekzistues të rinisë së punësuar në këto punë.
- Shifra e habitshme për perspektivën më të preferuar të punësimit është se 70 për qind e të anketuarve duan të punojnë në sektorin publik dhe vetëm 23 për qind në sektorin privat. Dëshira për të punuar për sektorin publik është mjaft problematike në krahasim me vendet e tjera në rajon. Vetëm 18 për qind e të rinjve të punësuar në Kosovë po punojnë në sektorin publik, ndërkohë që mospërputhja ndërmjet gjendjes reale dhe preferencave është më e larta në rajon.
- Siguria e punës është faktori kryesor që të rinjtë në Kosovë konsiderojë në zgjedhjen e një pune. Kjo nënkupton një shqetësim të madh mbi të drejtat e punonjësve, orët e gjata të punës, problemet me pagat, etj. Ata që janë më të shqetësuar për sigurinë e punës kanë dëshirë më të lartë për të punuar në sektorin publik dhe janë më pak të kënaqur me cilësinë e arsimit në Kosovë.

Kosova, Bosnjë dhe Hercegovina dhe Shqipëria kanë nivele të larta papunësie. Papunësia është më e përhapur tek të rinjtë me prindër të një niveli të ulët arsimor, familje të varfra dhe shumica nga zona rurale.

Kosova ka një shifër të lartë të NEET (të rinjtë që nuk janë as në arsim as në trajnim, as të punësuar, dhe mund të quhen “shpirta të humbur”⁴). Për qindja e atyre që nuk janë as të punësuar as në arsim është rreth 25 për qind (BE 28 mesatarja 2014: 17 për qind). Nga ana tjetër pothuajse 23 për qind e të rinjve janë të punësuar, ose në punë dhe arsim në të njëjtën kohë (8 për qind).

Nga ana tjetër, shumica e të rinjve merret me një lloj edukimi apo trajnimi. 52 për qind e të rinjve janë duke marrë pjesë vetëm në arsimin dhe nuk janë të punësuar, dhe një tjetër 8 për qind është duke

DIAGRAMI 8.1: **Niveli i papunësisë (mosha 15–29), në përqindjen e fuqisë punëtore**




marrë pjesë si në edukim dhe punësim. Rinia NEET është më e përçrduar në zonat rurale. Për më tepër, pabarazia gjinore në statusin social është shumë e lartë. Femrat që kanë nivele të lartë të NEET dhe arsimin, ndërsa meshkujt janë më prezent në tregun e punës.


FAKTORË TË RËNDËSISHËM PËR TË GJETUR NJË PUNË

Ekzistojnë disa faktorë që konsiderohen se kanë një ndikim të ngjashëm në gjetjen e një pune. Perceptimi mbizotërues është që të njohurit dhe lidhjet me njerëz në pushtet, do të thotë se pozicioni i individit në strukturën shoqërore konsiderohen si shumë të rëndësishëm në 54–58 për qind të rasteve. Për më tepër, arsimi dhe ekspertiza kanë të njëjtin ndikim. Nga ana tjetër anëtarësia në parti dhe origjina janë më pak të rëndësishme. Ka një dallim të lehtë lidhur me gjininë, ku gratë konsiderojnë si faktorë të rëndësishëm për të gjetur një punë ekspertizën dhe nivelin e arsimit, ndërsa meshkujt janë më të orientuar për të përdorur të njohurit dhe lidhjet me personat në pushtet.

DIAGRAMI 8.2: **Angazhimi i të rinjve në arsim dhe punësim**




DIAGRAMI 8.3: Faktorët e rëndësishëm për të gjetur punë



MOSPËRPUTHJA E SHKATHTËSIVE



Të rinjtë në Kosovë janë shpesh (54 për qind e tyre) duke punuar në punë jashtë profesionit të tyre. Prej të rinjve që aktualisht janë të punësuar, vetëm 27 për qind janë aktualisht duke punuar në profesionin e tyre të zgjedhur, ndërsa 9 për qind bëjnë punë që kanë lidhje me profesionin e tyre. Kjo është një ulje neto prej 6 për qind krahasuar me 2012. Nga ana tjetër, ka një rritje të lartë të të rinjve që deklarojnë se nuk punojnë në profesionin e tyre, me një kalim nga 36 për qind në 54 për qind të të rinjve që janë pjesë e fuqisë punëtore në gjashtë vitet e fundit. Kjo tregon një mospërputhje të madhe ndërmjet kualifikimeve të forcës së punës dhe nevojave dhe kërkesës së tregut për fuqi punëtore. Femrat duken se kanë një tendencë më të lartë për të punuar në profesionin e tyre, ndërsa djemtë priren të mos punojnë në profesionin e tyre (Spearman’s rho=-.180, p=0.008). Sa më i ulët të jetë niveli i arsimit të babait, aq më e mundshme është që të rinjtë të mos punojnë në profesionin e tyre (Spearman’s rho=-.188, p=0.005). Nga ana tjetër, të rinjtë që kanë marrë pjesë në stazhe dhe praktika kanë shanse më të mëdha për të punuar në profesionin e tyre (Chi-Square e Pearson V=28.634, Korrelacioni Spearman =.344, p<0.001).

DIAGRAMI 8.4: Të rinjtë që punojnë ose jo në profesionin e tyre



MBIEDUKIMI

Mbiedukimi është një tjetër dimension i rëndësishëm i mospërputhjes së aftësive të larta dhe paraqet një problem të rëndësishëm në Kosovë, Serbi dhe Shqipëri. Në Kosovë rreth 44 për qind e punëve aktuale për rininë kërkojnë një nivel më të ulët të arsimit formal krahasuar me nivelin ekzistues të të rinjve të punësuar në këto punë. Një tjetër 46 për qind e të rinjve në Kosovë duket se kanë një punë në përputhje me nivelin e arritur të arsimit, shifër që është pothuajse dy herë më e ulët krahasuar me Kroacinë apo Bullgarinë. Nuk është surprizë që mbiedukimi është më i përhapur në mesin e të rinjve me arsim të lartë në Kosovë (Spearman’s rho=-.201, p=0.004).

DIAGRAMI 8.5: **Kërkesat formale për vende të punës së të rinjve**DIAGRAMI 8.6: **Zgjedhja e sektorit të preferuar të punës**

ZGJEDHJA E VENDIT TË PUNËS

Vetëm një pjesë e vogël e rinisë në Kosovë është pjesë e forcës së punës. Shifra e habitshme mbi perspektivën më të preferuar të punësimit është se 70 për qind e të anketuarve duan të punojnë në sektorin publik dhe vetëm 23 për qind në sektorin privat. Vetëm 47 për qind e të rinjve kosovarë preferonin një punë në sektorin publik në 2012. Vlen për t'u përmendur rënia e qëllimeve të rinisë për të punuar për një institucion ndërkombëtar nga 19 për qind në 2012 në 5 për qind në 2018. Rënia e prezencës së institucioneve ndërkombëtare në Kosovë ka pasur implikime edhe në numrin e të rinjve kosovarë, që duan të punojnë për to.


Dëshira për të punuar për sektorin publik është problematike krahasuar me vendet e tjera në rajon. Vetëm 18 për qind e të rinjve të punësuar në Kosovë punojnë në sektorin publik, ndërsa mospërputhjet ndërmjet gjendjes reale dhe preferencave janë nga më të lartit në rajon. Femrat janë më të prira të punojnë në sek-

torin publik (71 për qind), ndërsa meshkujt kanë më shumë mundësi në sektorin privat.


FAKTORËT NË ZGJEDHJEN E NJË PUNE

Në zgjedhjen e një pune, të rinjtë janë të orientuar kryesisht nga konsideratat e të drejtave të punës, që konsiderohen si shumë të rëndësishme në 83 për qind të rasteve. Siguria në punë dhe koha e lirë përtej punës, konfirmojnë diskutimet e fokus grupeve se shqetësimet kryesore të punonjësve në sektorin privat janë të drejtat e punonjësve, orët e gjata të punës dhe problemet me pagën. Ka disa lidhje të rëndësishme statistikore lidhur me sigurinë e punës së të rinjve në Kosovë. Ata që janë të shqetësuar për sigurinë në punë janë më të bindur se të ardhurat e të varfërve dhe të pasurve duhet të jenë të barabarta. (Spearman's rho=.244,

DIAGRAMI 8.7: Puna në sektorin publik: realiteti dhe preferencat



DIAGRAMI 8.8: Faktorët kryesorë për zgjedhjen e vendit të punës



$p < 0.001$) në një lidhje të fortë. Përkeqësimi i kushteve të punës po shtyn të rinjtë për të përkrahur më shumë politika të djathta. Në të njëjtën kohë, ata që janë të shqetësuar për sigurinë në punë në të njëjtën kohë janë të interesuar në politikë. (Spearman’s $\rho = .091$, $p = 0.005$). Padyshim, ata kanë një dëshirë të madhe për të punuar në sektorin publik, pasi konsiderohet se ofron më shumë siguri në punë (Spearman’s $\rho = -.096$, $p = 0.002$). Në të njëjtën kohë, ata që nuk kanë siguri në punë janë në përgjithësi të pakënaqur me cilësinë e arsimit (Spearman’s $\rho = -.083$, $p = 0.009$), por nga ana tjetër duken më të kënaqur me jetën e tyre në përgjithësi (Spearman’s $\rho = .220$, $p < 0.001$).

Të rinjtë që janë më të interesuar në të ardhura/paga, janë pak më prezentë në zonat rurale (Spearman’s $\rho = .095$, $p = 0.003$), dhe gjithashtu duken më të kënaqur me jetën e tyre në përgjithësi (Spearman’s $\rho = .088$, $p < 0.001$).

Diskutimet në fokus grupe tregojnë se punët në sektorin publik janë më të preferuara për shkak të sigurisë në punë, kontratave të përhershme dhe të drejtave të punonjësve. “Unë preferoj të

punoj në sektorin publik pasi punëdhënësit e sektorit privat nuk paguajnë taksa apo pension. As rrogën nuk e japin çdo muaj. Ata kanë kushte më të mira në sektorin publik si pushimet vjetore.” (Dragash, femër, 28 vjeç). Nga ana tjetër duket shumë e vështirë për të gjetur një punë në sektorin publik “Pasja e një lidhje politike është faktori kryesor për të gjetur punë. Nëse një person do të punësohet në sektorin publik, i duhet një diplomë dhe lidhje fisnore apo politike. Është shumë e rëndësishme t’i përkasësh një partie politike ose të kesh lidhje për të pasur qasje në këto institucione.” (Prishtinë, femër, 26 vjeç).

DISKUTIM PËR PUNËSIMIN

Rezultatet e studimit pasqyrojnë mospërputhjen e lartë midis furnizimit të tregut të punës dhe kërkesës për punë në të gjithë brezin e të rinjve.

Gjetjet e anketimit nënvizojnë frikën e të rinjve lidhur me shansin për të punuar në sektorin privat krahasuar me sektorin publik. Rrogat më të ulëta në sektorin privat, së bashku me nivelin e ulët të sigurisë në punë janë disa çështje themelore që kanë rritur mosbesimin në tregun e punës dhe mjedisin ekonomik.

9


DEMOKRACIA DHE QEVERISJA

Në këtë pjesë të studimit kemi prezantuar pikëpamjet e të rinjve në Kosovë mbi politikën – ndjenjën e përfaqësimit dhe ndikimit në politikë, besimit në institucione dhe orientimet e tyre ideologjike. Mënyra si e shohin të rinjtë sistemin politik dhe politikën në një shoqëri është e rëndësishme për pjesëmarrjen aktive në shoqëri demokratike, dhe besimin që është mirë për të gjithë dhe siguron kushte të barabarta për zhvillim.

Kosova pati një aktivitet politik shumë intensiv në 2017 pasi zgjedhjet parlamentare dhe lokale u zhvilluan në të njëjtin vit (zgjedhjet lokale në 22 tetor 2017 dhe zgjedhjet parlamentare në 11 qershor 2017).

GJETJET KRYESORE

- Ka një rënie dramatike të interesimit të të rinjve në ngjarjet politike krahasuar me 2012. Të rinjtë shprehin shumë më pak interes në qeverisjen vendore. Dy të tretat e të rinjve në Kosovë nuk diskutojnë ose diskutojnë rrallë për politikë me familjen apo të njohurit. Të rinjtë janë më të prirë për diskutime politike me familjen ose të njohurit kur kanë përfunduar nivele të larta të arsimit apo kur jetojnë në zona urbane.
- Ndikimi i prindërve në pikëpamjet politike të të rinjve në Kosovë nuk është i lartë. Pothuajse një e treta e të rinjve në Kosovë nuk kanë të njëjtat pikëpamje dhe besime me prindërit e tyre, ndërsa një e katërta e të rinjve nuk e dinë ose nuk i përgjigjen kësaj pyetjeje. Këto shifra tregojnë një mundësi të lartë zhvendosje të orientimit politik ndërmjet brezave.
- Vetëm 10 për qind e të rinjve kosovarë janë të mendimit që interesat e tyre janë të përfaqësuara “mirë” në politikën kombëtare. Kjo pikëpamje mbi *mungesën e përfaqësimit* është pothuajse e njëjtë në aspektet kryesore demografike të popullsisë së re (urbane, gjini, moshë, etj.).
- TV dhe Interneti janë mjeti kryesor i informimit për çështje politike, megjithëse interneti i kombinuar me rrjetet sociale përbëjnë të tashmen dhe të ardhmen e botës së informacionit për të rinjtë. Sa më shumë të rinj përdorin internetin si mjet informacioni, aq më pak të ngjarë ka që të kenë votuar në zgjedhjet e fundit, dhe janë më pesimistë për gjendjen ekonomike të Kosovës në të ardhmen.
- Megjithëse të rinjtë preferojnë të thonë se nuk janë të interesuar në politikën kombëtare, të rinjtë në Kosovë kanë një pjesëmarrje të lartë në zgjedhjet e fundit. Këto të dhëna tregojnë se ka arsye të tjera që motivojnë të rinjtë për të votuar.
- Të rinjtë e Kosovës e kanë të vështirë të përcaktojnë se cilit drejtimi politik i përkasin “të majtës” apo “të djathtës”. Sa i përket pozicionimit në shkallë në drejtim të anëve politike të majta-të djathta, të rinjtë prirën të kenë problem me të kuptuarit e këtyre kategorive dhe pozicionimin e tyre në shkallë. Një shumicë e vogël e të anketuarve besojnë se kanë orientim politik “të krahut të djathtë”, por mbështesin opinionet “e krahut të majtë” mbi çështjet ekonomike dhe sociale, si dhe rolin e shtetit në sigurimin e mirëqenies sociale.
- Ekziston një mosbesim dhe apati e të rinjve kosovarë ndaj të gjitha institucioneve politike, veçanërisht për partitë politike dhe qeverinë kombëtare. Për më tepër, ekziston një skepticizëm i madh tek të rinjtë rreth organizatave të shoqërisë civile dhe mediave. Nga ana tjetër, ka më shumë besim tek institucionet fetare dhe organizatat ndërkombëtare si NATO dhe OSBE.
- Një e katërta e të rinjve në Kosovë janë të kënaqur me situatën e demokracisë në Kosovë. Trazirat politike dhe qeveritë e


DIAGRAMI 9.1: **Interesi në ngjarjet politike**

brishta shtyjnë pothuajse 60 për qind të të rinjve në Kosovë për të favorizuar një udhëheqje të fortë, që përbën 18 për qind që favorizojnë një diktaturë të qartë nën disa rrethana.

- Shprehja e një pozicioni politik përmes aktivizimit qytetar nuk është e përhapur, pasi vetëm 13 për qind kanë marrë pjesë në aktivitete të shoqërisë civile si vullnetarë. Të rinjtë që jetojnë në zonat urbane dhe janë anëtarë të familjeve në pozicione më të mira ekonomike janë më të prirë për të marrë pjesë në aktivitete politike.
- Edhe pse ekziston një nivel i lartë zhgënjimi me situatën në të gjitha fushat e rëndësishme që kanë të bëjnë me të tashmen dhe të ardhmen, të rinjtë në Kosovë ndjehen mjaft optimist në parashikimin e tyre për të ardhmen, pasi 62 për qind e tyre mendojnë se situata ekonomike e njerëzve në Kosovë do të përmirësohet në 10 vitet e ardhshme. Të rinjtë që janë pjesë e familjeve me kushte jo të favorshme ekonomike janë më optimistë për të ardhmen, së bashku me të rinjtë që jetojnë në zonat rurale.
- Është e habitshme që në të dy grupet kryesore etnike të dalin “njerëz të varfër” dhe “njerëz me aftësi të kufizuara”, si grupet që kanë më së paku të drejta në Kosovë. Kjo konfirmon se problemet më të mëdha janë të një natyre sociale-ekonomike, të lidhura me varfërinë dhe papunësinë.

Rinia nuk shpreh interes të madh në ngjarjet politike, pavarësisht nëse kanë të bëjnë me politikën globale, politikën në qeverisjen lokale, Kosovën apo politikën e BE-së. Nëpërmjet 65 për qind dhe 76 për qind të të anketuarve⁵ nuk janë të interesuar apo nuk janë të interesuar fare në ngjarjet politike që varen nga shkalla e ngjarjeve politike. Të rinjtë shprehin më shumë interes në qeverisjen vendore, ndjekur me politikën në nivel kombëtar, ndërsa ka më pak interes në BE dhe politikën nga bota.

Nga ana tjetër ka një ndryshim dramatik të të rinjtë e Kosovës krahasuar me të njëjtin studim të 2012. Në 2012 interesi në politika kombëtare ishte i konsiderueshëm, me rreth 56 për qind të rinisë së intervistuar që raportojnë se janë “shumë të interesuar” apo “të interesuar” në politikën e Kosovës, ndërsa pas 6 vjetësh, kjo shifër është 4 herë më e ulët (13 për qind). Kjo është lëvizje e

DIAGRAMI 9.2: **Interesi i të rinjve për politikën krahasuar me vitin 2012**


fortë në interes të politikës kombëtare së bashku me uljen e besimit të politikanët dhe institucionet

Diskutimet e fokus grupeve nxjerrin një situatë paksa të ndryshme. Pjesëmarrësit deklaruan se e perceptojnë politikën si pjesë të jetës së tyre të përditshme. Ata nuk marrin pjesë në iniciativa politike por janë të informuar, bëjnë biseda dhe debate pothuajse çdo ditë. Shumë nuk janë të kënaqur me zhvillimin e përgjithshëm politik. Perceptimi i tyre është se klasa politike është e korruptuar, por gjithashtu thekson se ky është rasti me të gjithë shoqërinë në Kosovë. “Si mund të jemi të lumtur kur Kryeministri ynë, i cili është shumë i pasur, rriti rrogën e tij? Kjo është gjithçka që ka bërë.” (Vushtrri, femër, 25 vjeç).

Të anketuarit janë më të interesuar në politikën kombëtare kur kanë përfunduar nivelet e lartë të arsimit (Spearman’s rho=.224, p<0.001), apo babai i tyre ka përfunduar nivel të lartë të arsimimit (Spearman’s rho=.233, p<0.001). Të rinjtë më të mëdhenj janë padyshim më të interesuar në politikë sesa bashkëmoshatarët e tyre më të rinj (Spearman’s rho=.153, p<0.001). Për më tepër, të rinjtë që jetojnë në zona urbane janë pak më të interesuar se ata në zona rurale (Spearman’s rho=-.129, p<0.001).

Të anketuarit në grupe të ndryshme etnike kanë përgjigje shumë të ndryshme mbi këtë pyetje. Shqiptarët e Kosovës duket se nuk janë të interesuar në politikë, ndërkohë që serbët dhe turqit e Kosovës kanë më shumë interes në politikën kombëtare dhe lokale, ose politikën në përgjithësi.

DIAGRAMI 9.3: Mosinteresimi për politikën i grupeve etnike (duke treguar përqindjet e atyre që janë “aspak të interesuar” dhe “jo të interesuar”)





SA SHPESH DISKUTONI PËR POLITIKËN ME FAMILJEN TUAJ APO TË NJOHURIT?

Rreth 63 përqind e të rinjve kosovarë u përgjigjën “kurrë” ose “rrallë” kur u pyeten se sa shpesh diskutojnë për politikë me familjen apo të njohurit. Të anketuarit diskutojnë më shumë politikë me familjen apo të njohurit kur përfundojnë nivele të lartë arsimit (Spearman’s rho=.265, p<0.001), ose kur i ati ka përfunduar nivel të lartë arsimimi (Spearman’s rho=.272, p<0.001). Të rinjtë më të vjetër janë qartësisht më të interesuar në politikë sesa më të rinjtë (Spearman’s rho=.207, p<0.001). Për më tepër, të rinjtë që jetojnë në zonat rurale janë pak më të interesuar sesa ata në

zonat rurale (Spearman’s rho=-.098, p<0.001). Ekziston një lidhje e fortë ndërmjet të rinjve që janë të interesuar në politikë kombëtare, me ata që diskutojnë më shumë këto çështje me familjen dhe fëmijët (Spearman’s rho=.576, p<0.001).

DERI NË Ç’MASË PËRPUTHEN PIKËPAMJET DHE BESIMET TUAJA POLITIKE ME ATO TË PRINDËRVE TUAJ?

Prindërit nuk ndikojnë shumë në pikëpamjet politike të të rinjve në Kosovë. Rreth një e treta e të rinjve në Kosovë nuk kanë të njëjtat pikëpamje dhe besime me prindërit e tyre, ndërsa një e

DIAGRAMI 9.4: **Niveli i diskutimit të politikës me familjen dhe miqtë**DIAGRAMI 9.5: **Ngjashmëria e pikëpamjeve politike midis të rinjve dhe prindërve**


katërta e të rinjve nuk dinë apo nuk i përgjigjen kësaj pyetjeje. Këto shifra tregojnë një zhvendosje të lartë të orientimit politik ndërmjet brezave.

Lidhjet statistikore tregojnë rezultate të ngjashme me pyetjet e mëparshme. Lidhja më e habitshme lidh faktin se pikëpamjet politike janë më të përputhura në familjet që diskutojnë më shpesh për politikën (Spearman's rho=.487, p<0.001). Edhe njëherë, sa më i lartë të jetë niveli i arsimimit të babait të familjes, aq më të ngjashme janë pikëpamjet politike të individëve të rinj me ato të prindërve (Spearman's rho=.223, p<0.001).


SA MIRË MENDONI SE JANË TË PËRFAQËSUARA INTERESAT E TË RINJVE NË POLITIKËN KOMBËTARE?

Vetëm 10 për qind e të rinjve kosovarë mendojnë se interesat e tyre janë të përfaqësuar "mirë" ose "shumë mirë" në politikën kombëtare. Ky mendim për mungesën e përfaqësimit është pot-huajse e njëjtë në aspektet kryesore demografike të të rinjve. Lidhja e vetme statistikisht e rëndësishme duket se të rinjtë janë shumë optimistë për situatën politike të njerëzve në Kosovë në 10 vitet e ardhshme (Spearman's rho=.150, p<0.001)

DIAGRAMI 9.6: Përfaqësimi i interesave të të rinjve në politikat kombëtare



DIAGRAMI 9.7: Burimi kryesor i informacionit për politikën




CILAT JANË BURIMET KRYESORE TË INFORMACIONIT MBI POLITIKËN?

Lidhur me interesin në ngjarjet politike, të rinjtë u pyetën se si marrin informacion mbi politikën. TV dhe interneti janë mjetet kryesore të informacionit mbi çështjet politike. Nëse kombinojnë internetin dhe mediat sociale online, kemi mjetin më të rëndësishëm mbi këto çështje. Ka një dallim interesant ndërmjet të rinjve që përdorin TV apo internet si burime kryesore informimi. Gazetat dhe radio vështirë se shërbejnë si burime informacioni për të rinjtë. Të rinjtë pjesë e grupit më të vjetër (24–29) përdorin internetin si mjetin kryesor të informimit (Spearman's rho=.071, p=0.025). Për më tepër, sa më i lartë niveli i arsimit, aq më shumë përdorin internetin si mjetin kryesor (Spearman's rho=.185, p<0.001). Nga ana tjetër, ata që përdorin internetin si mjet informacioni kanë pak të ngjarë të kenë votuar në zgjedhjet e fundit (Spearman's rho=-.165, p<0.001).

Të rinjtë që përdorin më së shumti TV për të marrë informacion, zakonisht janë pak më të rinj (Spearman's rho=-.063, p=0.046), kanë më pak arsim të përfunduar (Spearman's rho=-.079, p=0.013) dhe jetojnë më shumë në zonat rurale (Spearman's rho=.127, p<0.001). Ata kishin tendencë më të lartë për të votuar në zgjedhjet e fundit (Spearman's rho=.080, p<0.012), dhe janë shumë më optimistë për gjendjen ekonomike të Kosovës në 10 vitet e ardhshme (Spearman's rho=.143, p<0.001).


FIGURE 9.8: **Votimi në zgjedhjet e kaluara**



GJITHSEJ (N=616)

■ Po: 82 %
■ Jo, edhe pse e kisha të drejtën e votës: 18 %


DIAGRAMI 9.9: **A do të votonit nëse zgjedhjet do të mbaheshin sot?**



GJITHSEJ (N=1.000)

■ Po: 78 %
■ Jo: 13 %
■ Nuk e di: 8 %
■ Pa përgjigje: 1 %

DIAGRAMI 9.10: **Sjelljet ndaj politikave të caktuara**



VOTIMI NË ZGJEDHJE

Pas nivelit të ulët të interesit në politikë dhe niveli i ulët i diskutimeve rreth politikës, do të prisnim që një nivel i ulët i pashmangshëm i pjesëmarrjes së të rinjve në jetën politike është përdorimi i të drejtës demokratike të votës. Në këtë studim, të rinjtë u pyetën se sa shpesh votojnë në zgjedhjet parlamentare dhe lokale. Megjithatë niveli i interesit në politikë është i ulët, niveli i pjesëmarrjes së të rinjve në zgjedhje është shumë i lartë, pasi 82 për qind e atyre që kanë të drejtën e votës kanë votuar në zgjedhjet e fundit. Këto të dhëna tregojnë se mund të ekzistojnë arsye të tjera që duhen zbuluar në studime të mëtejshme që motivojnë të rinjtë të dalin dhe të votojnë, pavarësisht mungesës së interesit së tyre në politikë.

Në disa raste u gjetën dallime statistikisht të rëndësishme ndërmjet grupeve të të anketuarve. Gratë kishin më pak mundësi për të


votuar në krahasim me meshkujt (Spearman’s rho=-.068, p=0.025), dhe të rinjtë në zonat rurale kanë një shkallë më të lartë pjesëmarrjeje në zgjedhjet e fundit (Spearman’s rho=-0.065, p=0.033).

Ka rezultate shumë të ngjashme kur të rinjtë janë pyetur nëse do të votonin në zgjedhjet parlamentare dhe do të kishin mundësi për të votuar. 78 për qind e të rinjve do të votonin në zgjedhjet e ardhshme, dhe 13 për qind përgjigjen se nuk do të votonin.


QËNDRIMET E KUNDËRTA POLITIKE – KRAHU I MAJTË DHE I DJATHTË

Në lidhje me pozicionimin e dikujt lidhur me anët e majtë-djathtë të drejtimit politik, të rinjtë priren të kenë problem me kuptimin e këtyre kategorive dhe pozicionimin e tyre në. Shumica e të anketuarve (65 për qind) besojnë se më mirë të kenë një orientim

DIAGRAMI 9.11: Kënaqësia me gjendjen e demokracisë në Kosovë



DIAGRAMI 9.12: Dakordësia



politik të qendrës, ndërsa vetëm 20 për qind dhe 15 për qind ndajnë respektivisht pikëpamje politike të “krahut të djathtë” dhe “krahut të majtë”.

Kategoritë politike “djathtë-majtë” nuk do të thonë diçka për një numër të madh të të rinjve; prandaj qëndrimi i tyre ndaj politikës është i ndryshëm. Kur pyeten nëse të ardhurat e të varfërve dhe të pasurve duhet të jetë të barabarta, duket se ky qëndrim është më shumë i miratuar nga të rinjtë që janë deklaruar pjesë e krahut të “djathtë” politik duke reflektuar pasigurinë dhe kontradiktën në lidhje me këto aspekte politike (Spearman’s rho=.155, p=0.001). Për më tepër, të rinjtë që mbështesin më shumë idetë e “krahut të majtë” janë më të pranishëm në zonat rurale (Spearman’s rho=.093, p=0.003) dhe kryesisht nuk janë të kënaqur me gjendjen e demokracisë në Kosovë (Spearman’s rho=-.105, p=0.001).

SA TË KËNAQUR JENI ME GJENDJEN E DEMOKRACISË NË PËRGJITHËSI NË KOSOVË?

Vetëm 19 për qind e të rinjve në Kosovë janë “të kënaqur” ose “shumë të kënaqur” me gjendjen e demokracisë në Kosovë. Të rinjtë mbi 23 vjeç dhe më pak se 30 vjeç janë më pak të kënaqur krahasuar me grupet më të reja të moshës (Spearman’s rho=-.080, p=0.008). Në të njëjtën kohë, të rinjtë që kanë përfunduar nivele më të larta të arsimit në përgjithësi janë më pak të kënaqur me gjendjen e demokracisë (Spearman’s rho=-.099, p=0.001). Nga ana tjetër, të rinjtë që jetojnë në zona urbane janë pak më shumë të kënaqur me situatën e demokracisë në Kosovë (Spearman’s rho=-.062, p=0.039)


OPINIONET POLITIKE

Ekziston konsensus prej 77 për qind që rinia disi ose plotësisht pret që qytetarët kanë për detyrë të votojnë në një demokraci. Rreth 62 për qind ndajnë mendimin se demokracia është një formë e mirë qeverisje dhe opozita është e nevojshme për një demokraci të shëndetshme. Megjithatë trazirat politike dhe qeveritë e brishta me shumë mundësi shtyjnë pothuajse 60 për qind të të rinjve për të favorizuar një “drejtim të fortë”, që mund të përbëhet nga një udhëheqës i fortë demokratik apo një udhëheqës i fortë me tendencë diktatoriale. Për më tepër, duket se 18 për qind e të rinjve favorizojnë një diktaturë të pastër nën rrethana të caktuara.

TË RINJTË DHE PJESËMARRJA POLITIKE

Sa i përket mënyrave të tjera për shprehjen e qëndrimit politik, ka pak të rinj që përdorin disa forma kryesore të aktivizimit. Ne identifikuam masën në të cilën janë aktivë të rinjtë kosovarë në


DIAGRAMI 9.13: **Angazhimi në forma të ndryshme të aktivizimit**




jetën publike dhe qytetare, dhe nëse janë angazhuar në aktivitete të ndryshme. Rezultati i këtij studimi sasiore tregon se aktivizimi civil i të rinjve nuk është i përhapur, pasi vetëm 13 për qind kanë qenë vullnetarë në aktivitete të shoqërisë civile. Pjesëmarrja në aktivitete të tjera politike, si pjesëmarrja në protesta politike, nënshkrimi i peticionit është ende i ulët, rreth 11–12 për qind. Ndër metodat e tjera të shprehjes së pozicionit politik, rinia kosovare përdorë pak edhe “aktivizimin e konsumatorit”, që do të thotë shprehja e pozicionit politik ose mjedisor përmes bojkotimit të mallrave me origjinë nga një vend tjetër, edhe pse vetëm 9 për qind e të rinjve përdorin këtë mënyrë shprehjeje. Personat që jetojnë në zonat urbane (Spearman’s rho=-.174, p<0.001) dhe meshkujt (Spearman’s rho=.098, p=0.001) zakonisht kanë një tendencë pak më të lartë për t’u angazhuar në këto aktivitete. Për më tepër, të rinjtë që janë pjesë e familjeve në pozicione më të mira ekonomike janë më të prirë për të marrë pjesë në aktivitete qytetare (Spearman’s rho=.150, p<0.001). Sikurse pritej, të rinjtë kosovarë që janë më pak të kënaqur me jetën e tyre në përgjithësi kanë më shumë shanse për të marrë pjesë në aktivitete aktivizimi (Spearman’s rho=-.063, p=0.038).

Duke marrë në konsideratë ndarjen etnike, serbët e Kosovës kanë një aktivizëm vullnetarizmi më të lartë, duke pasur të paktën 30 për qind të të rinjve që kanë marrë pjesë në aktivitete vullnetare, dhe pak më shumë angazhim në aktivitete politike.


DIAGRAMI 9.14: **Objektivat e preferuara ku duhet të fokusohet qeveria**



DIAGRAMI 9.15: **Pritjet për situatën ekonomike në të ardhmen në Kosovë**



DIAGRAMI 9.16: **Grupet që nuk kanë shumë të drejta**



NË ÇFARË MASE DUHET TË PËRQEN- DROHET QEVERIA KOMBËTARE NË REALIZIMIN E OBJEKTIVAVE TË MËPOSHTME?


Detyra prioritare për Qeverinë kërkuar nga të rinjtë e Kosovës është zgjidhja e çështjes së papunësisë dhe ky opinion ndahet në tri grupet e mëdha etnike në Kosovë. Detyra të tjera të rëndësishme për t'u përqendruar përfshijnë rritjen ekonomike dhe luftën kundër krimit dhe korrupsionit. Ky pozicion pasqyron qëndrimin e shumicës së të rinjve në Kosovë mbi prioritetet politike. Gjetjet e studimit tregojnë një perceptim relativisht homogjen të shqiptarëve të Kosovës dhe serbëve të Kosovës për një shumëllojshmëri çështjesh, me pak dallime statistikore mbi disa çështje. Shqiptarët e Kosovës duket se presin gjithçka nga Qeveria, pasi konsiderojnë të paktën nëntë objektiva si shumë të rëndësishme për më tepër se 70 për qind të miratimit të tyre. Lufta kundër korrupsionit është objektivi i dytë për Qeverinë si për serbët dhe turqit e Kosovës. Serbët në Kosovë duket se nuk janë dakord me forcimin e fuqisë ushtarake dhe identitetit kombëtar. Grafiku tregon se pothuajse çdo problem i pyetur në shkallën e këtij studimi ishte alarmues për të rinjtë shqiptarë nga Kosova.

Një pjesë e konsiderueshme e pjesëmarrësve të grupeve të fokusit kanë pranuar se kanë qenë dëshmitarë të rryshfetit apo nepotizmit në aspektet e arsimit dhe punësimit, duke konfirmuar se punësimi i drejtë së bashku me papunësinë dhe korrupsionin mbeten detyrat prioritare kryesore që Qeveria duhet të luftojë për një të ardhme më të mirë të të rinjve në Kosovë.

SITUATA EKONOMIKE NË KOSOVË NË 10 VITET E ARDHSHE


Për sa i përket pritshmërive në të ardhmen, të rinjtë shqiptarë të Kosovës ndjehen mjaft optimistë, pasi 62 për qind e tyre mendojnë se gjendja ekonomike në Kosovë do të përmirësohet gjatë 10 viteve të ardhshme (34 për qind – do të përmirësohet ndjeshëm, 28 për qind – do të përmirësohet në njëfarë mase). Është e pritshme që shumë pak serbë të Kosovës të presin që situata ekonomike në Kosovë të përmirësohet, pasi pjesa më e madhe mendojnë se kjo situatë nuk do të ndryshojë. Të rinjtë turq nga Kosova duket se kanë një mendim ndërmjet dy grupeve të tjera etnike, megjithëse një numër i caktuar i tyre dinin si t'i përgjigjeshin kësaj pyetje. Ligja statistikore tregon se të rinjtë që janë të varfër sipas shkallës së indeksit të pasurisë janë më optimistë për të ardhmen (Spearman's rho=-.070, p=0.021). Për më tepër, të rinjtë që jetojnë në zona rurale janë gjithashtu më optimistë (Spearman's rho=.160, p<0.001).

DIAGRAMI 9.17: Vlerat më të rëndësishme




CILAT GRUPE NUK KANË TË DREJTA TË MJAFTUESHME NË VENDIN TUAJ?

Është për t'u habitur që të dy grupet kryesore etnike veçojnë "njerëzit e varfër" dhe "njerëzit e paafat" si grupet që kanë më pak të drejta në Kosovë. Kjo ndoshta lidhet me qëndrimin e qartë për problemet në shoqërinë kosovare, pasi problemet më të mëdha janë të natyrës socio-ekonomike, të lidhura me varfërinë dhe papunësinë, dhe fshehin çështje të tjera që mund të jenë të lidhura me shprehjen e të drejtave në shoqërinë kosovare. Gjetjet e studimit duken se janë relativisht më homogjene lidhur me perceptimin ndërmjet grupeve etnike, përveç kur u pyetën rreth të drejtave të grupeve etnike.

DIAGRAMI 9.18: **Besimi tek institucionet**

Në një shkallë nga 1 në 5 ku 1=aspak dhe 5=plotësisht

DIAGRAMI 9.19: **Diferencat në besimin e institucioneve në mes të rinjve shqiptarë dhe serbë**

Në një shkallë nga 1 në 5 ku 1=aspak dhe 5=plotësisht

■ Shqiptarë

■ Serbë

TRI VLERAT MË TË RËNDËSISHME

Kur u pyetën për tre vlerat më të rëndësishme për të rinjtë e Kosovës, vlera kryesore e rëndësishme për shqiptarët e Kosovës mbetet papunësia (67 për qind), ndërsa serbët e Kosovës janë gjithashtu të fokusuar në mirëqenien ekonomike të qytetarëve (59 për qind). Vlen të përmendet se të dy grupet përfshijnë të drejtat e njeriut si një nga tre vlerat më të larta.

Nga ana tjetër, serbët e Kosovës janë më të shqetësuar për "sigurinë", një vlerë që ata e konsiderojnë si një nga tri vendet e para të rëndësishme në 60 për qind të rasteve.

BESIMI TEK INSTITUCIONET

Sipas këtij studimi, të rinjtë kanë besim tek organizatat ndërkombëtare, institucionet e Bashkimit Evropian dhe NATO më shumë se institucionet kombëtare ose vendore. Besimi i lartë tek organizatat ndërkombëtare mund të shpjegohet nga roli aktiv i institucioneve ndërkombëtare në mbështetjen e Kosovës për të fituar pavarësinë dhe ndërtuar demokracinë.

Të anketuarve u është kërkuar të vlerësojnë disa grupe dhe institucione në një shkallë besimi 1–5, ku 1 do të thotë “aspak” dhe 5 do të thotë “plotësisht besim”.

Ndër të rinjtë kosovarë, partitë politike, Qeveria, Parlamenti dhe Presidenti janë grupet më pak të besuara, duke shënuar më pak se 2 pikë në shkallën e besimit prej 5 pikësh. Ky informacion, sipas të cilit të rinjtë në Kosovë kanë më shumë besim tek institucionet politike ndërkombëtare në krahasim me institucionet vendore, median dhe shoqërinë civile, është i tregues i keq i gjendjes së demokracisë. Besimi i dhënë policisë dhe ushtrisë janë shembujt e vetëm të mirë të institucioneve që ende kanë besim të lartë dhe duhet të përdoren si shembull për institucionet e tjera vendore.

Dallimet statistikisht të rëndësishme dhe një ndarje e qartë ndërmjet dy grupeve etnike janë gjetur për të paktën 9 institucione. Shqiptarët e Kosovës kanë një besim shumë të madh në organizatat ndërkombëtare, duke filluar nga NATO, Kombet e Bashkuara, BE, FMN dhe OSBE. Nga ana tjetër, serbët e Kosovës kanë shumë pak besim te NATO, FMN dhe OSBE dhe besim mesatar tek Kombet e Bashkuara.

Megjithatë, ka vetëm dy raste kur të rinjtë serbë të Kosovës kanë besim më të lartë krahasuar me shqiptarët e Kosovës. Ata kanë një besim më të lartë në organizatat e shoqërisë civile dhe qeverisjen vendore.

DISKUTIM

Në kuptim të ideologjisë politike, në shumicën e rasteve, të rinjtë në Kosovë janë të prirë për të shmangur një orientim të qartë politik. Nga ana tjetër ata besojnë se Qeveria është përgjegjëse për sigurimin e një mjedisi të barabartë shoqëror dhe për sigurimin e çdo qytetari me nevojat themelore. Për më tepër, të rinjtë e disavantazhuar kanë një nevojë më të madhe për drejtësi sociale. Megjithatë nevoja për më shumë politika sociale nuk ndiqet nga aktivizmi qytetar i të rinjve, pasi ndihen të sigurt duke qenë të mbështetur nga familjet e tyre.

Nga studimi rezulton se të rinjtë kosovarë janë më pak të interesuar në aktivitetet politike dhe kanë sjellje negative drejt politikanëve dhe institucioneve politike. Të rinjtë e shikojnë politikën si biznes joformal dhe personat e përfshirë në politikë kanë fuqi më të madhe dhe veprojnë vetëm për interesat e tyre personale.

Të rinjtë në Kosovë e ndjejnë veten të përjashtuar nga proceset vendimmarrëse.

10



ASPIRATAT PËR TË MIGRUAR

Ky studim analizon disa aspekte të migrimit të të rinjve. Flukset e migracionit – të vullnetshme dhe të pavullnetshme kanë qenë një tipar i vazhdueshëm i ndryshimeve të popullsisë në Kosovë. Për dy dekadat e fundit, flukset e migracionit janë rritur në mënyrë drastike në kuadër të shpërbërjes së Jugosllavisë dhe luftës për pavarësi. Në 2014–2015 pati një valë të re migrimi drejt Bashkimit Evropian. Ndërsa këta të rinj, me mundësitë e tyre krijuese po japin kontributin e tyre pozitiv në shoqëri të tjera të zhvilluara, vendi i tyre i origjinës mbetet në grupin e vendeve më pak të zhvilluara në Evropë.

Më 14 qershor 2012, Kosova mori udhërrëfyesin për liberalizimin e vizave. Udhërrëfyesi liston të gjitha reformat dhe kërkesat që duhet të plotësojë Kosova për t'u kualifikuar për udhëtim pa viza drejt vendeve të zonës Shengen. Në fakt, kjo ka qenë një pritje e gjatë. Kosova është i vetmi vend në Ballkan ku qytetarëve të saj ende ju kërkohet një vizë për të hyrë në zonën Shengen. Kosova po pret për vendimin përfundimtar mbi procesin e liberalizimit të vizave nga Parlamenti Evropian.

GJETJET KRYESORE

- Shumica e të rinjve të Kosovës nuk synojnë që të studiojnë ose të trajnohen jashtë vendit. Këto të dhëna tregojnë një integritet të ulët për sistemet e huaja të trajnimit dhe arsimit, ndërsa shumica e të rinjve kosovarë presin që të kenë një trajnim dhe arsim në vend.
- Afërsisht gjysma e të rinjve shqiptarë të Kosovës kanë një qëllim nga i moderuar deri në shumë të fortë për t'u larguar nga Kosova. Njëkohësisht rreth 55 për qind e serbëve të Kosovës janë përgjigjur në të njëjtën mënyrë. Nuk ka asnjë dallim në qëllimin për të migruar mes grup moshave, niveleve të arsimit dhe rezultateve të indeksit të pasurisë, kështu që të gjithë grupet e ndryshme kanë qëllime të ngjashme për të migruar.
- Nga të anketuarit tanë që kanë treguar dëshirë për të migruar, shqiptarët e Kosovës duket sikur kanë qëllim më të fortë për të migruar, të paktën në 51 për qind të rasteve. Nga ana tjetër, ata serbë të Kosovës që kanë qëllim të migrojnë, në 55 për qind të rasteve nuk janë të sigurt se kur do të migrojnë.
- Afërsisht 40 për qind e shqiptarëve të Kosovës dëshirojnë të migrojnë për një periudhë të shkurtër kohe prej më pak se pesë vjet. Nga ana tjetër, ata që dëshirojnë të migrojnë njëherë e mirë janë afër 35 për qind. Të rinjtë që jetojnë në zonat rurale kanë një dëshirë më të fortë për të migruar për periudha më të gjata.
- Arsyet ekonomike përmenden si arsyeja kryesore për migrim nga rreth 63 për qind e atyre që dëshirojnë të lënë Kosovën për të shkuar në një vend tjetër. Ata që mund të konsiderohen si të "varfër" janë më të gatshëm të përmendin arsyet ekonomike për migrim.
- Zvicra dhe Gjermania janë vendet më të preferuara për të migruar nga kosovarët, pasi ato janë preferenca kryesore për migrim në 49 për qind të rasteve. Ka një rritje të dukshme të preferencave për Francën, Austrinë dhe Suedinë dhe ka një rënie të preferencave për SHBA-në dhe Anglinë.
- Një e katërta e të rinjve nga Kosova që dëshirojnë të migrojnë kanë njohje të mirë të gjuhës së punës të vendit të planifikuar si destinacionin e tyre. Interesante është se shumica e atyre që dëshirojnë të migrojnë nuk bëjnë asgjë për të përgatitur veten e tyre paraprakisht për migrimin në të ardhmen, ose ata vetëm kanë dëshirën për të migruar, pa ndërmarrë hapa të mëtejshëm për të materializuar procesin e migrimit.

DIAGRAMI 10.1: **Qëllimet për të studiuar jashtë shtetit**DIAGRAMI 10.2: **Qëllimi për të emigruar për më shumë se 6 muaj**

Ekziston një numër i lartë prej 63 për qind e të rinjve nga Kosova që do të pranonin punë të cilat nuk dëshirohen nga popullsia lokale. Ata që pranojnë punë më pak të dëshiruara janë duke migruar për "arsye ekonomike" dhe qartësisht janë të lidhur me kuintilen "më të varfër" të indeksit të pasurisë.

Në kuadër të këtij hulumtimi, të anketuarve iu bënë një grup pyetjesh mbi aspiratat e mundshme për të ndryshuar vendin e banimit, motivet përkatëse dhe vendet e preferuara ku ata dëshirojnë të migrojnë.

TË MËSUARIT OSE TRAJNUARIT JASHTË

Megjithëse ekziston një diasporë e fuqishme jashtë, veçanërisht në Evropë, shumica e të rinjve kosovarë (61 për qind e rasteve) nuk synojnë që të studiojnë ose trajtohen jashtë vendit. Shumë pak prej tyre kanë eksperiencën e të qenit jashtë dhe kontakti i tyre me botën nuk është i konsiderueshëm. Vetëm tre për qind e të rinjve kosovarë kanë qenë jashtë vendit për qëllime studimi të nivelit të arsimit të lartë. Një tre përqindësh tjetër ka qenë jashtë për trajnime dhe arsim profesional. Këto të dhëna tregojnë një integrim të ulët të të rinjve kosovarë me sistemet arsimore dhe trajnuese të huaja dhe ata presin që të kenë më shumë

trajnim dhe arsim në vend. Të rinjtë që jetojnë në zonat rurale kanë pasur më shumë eksperiencë studimi jashtë vendit. Të rinjtë e Kosovës dëshirojnë të ikin jashtë shtetit, por jo kryesisht për arsye studimi.

Vetëm 12 për qind e të rinjve kanë qenë larg Kosovës për më shumë se gjashtë muaj. Këta mund të konsiderohen si “të kthyerit”, në kuptimin që ata kanë qenë pjesë e migracionit, por për shumë arsye kanë vendosur që të kthehen në Kosovë.



QËLLIMI PËR TË MIGRUAR PËR MË SHUMË SE GJASHTË MUAJ



47 për qind e të rinjve shqiptarë në Kosovë kanë qëllim nga i moderuar deri në të fortë për t’u larguar nga Kosova. Njëkohësisht rreth 53 për qind e serbëve të Kosovës janë përgjigjur në të njëjtën mënyrë. Nuk ka asnjë dallim në qëllimin për të migruar midis grup moshave të ndryshme ose niveleve arsimore. Nuk ka asnjë dallim edhe në rastet e të rinjve që janë pjesë e familjeve me gjendje të ndryshme ekonomike. Ekziston vetëm një korrelacion i rëndësishëm statistikor që është identifikuar midis këtij variabëli dhe gjinisë së të anketuarit, pasi meshkujt kanë një prirje më të lartë për të migruar (Spearman’s rho=.062, p=0.041). Sikurse pritej, ata që kanë dëshirë më të

madhe për të migruar lidhen reciprokisht me ata që dëshirojnë të migrojnë sa më shpejt që të jetë e mundur (Spearman’s rho=-.263, p<0.001) dhe ata që dëshirojnë që të qëndrojnë më gjatë në vendin e destinacionit (Spearman’s rho=.304, p<0.001).

KOHA PËR TË MIGRUAR NGA KOSOVA DHE PLANET E MIGRACIONIT

Në lidhje me kohën për migrim, ka një dallim të madh midis shqiptarëve dhe serbëve të Kosovës. Vetëm të anketuarit që tregojnë një farë dëshire për të migruar u pyetën rreth kohës së kur ata mendojnë se do të largohen nga Kosova për të migruar jashtë. Shqiptarët e Kosovës duket sikur kanë një synim më të madh për të migruar në të ardhmen e afërt, të paktën në 51 për qind të rasteve. Serbët e Kosovës kanë kryesisht dëshirë për të migruar, por në 55 për qind të rasteve nuk janë të sigurt se kur do të migrojnë. Ne kemi testuar disa tregues në mënyrë që të gjejmë rëndësinë statistikore me dëshirën për të migruar sa më parë që të jetë e mundur dhe kemi gjetur disa korrelacione.



DIAGRAMI 10.5: Arsyet për të emigruar (krahasim 2012 me 2018)**DIAGRAMI 10.6: Shtetet e preferuara për të emigruar në 2012 dhe 2018**


Mosha e të rinjve tregon një korrelacion të fortë, pasi sa më të moshuar bëhen, aq më shpejt dëshirojnë të migrojnë jashtë (Spearman's $\rho = -.354$, $p < 0.001$). Njëkohësisht, të rinjtë meshkuj dëshirojnë të migrojnë më shpejt, në të njëjtën prirje me të rinjtë që jetojnë në zonat rurale (Spearman's $\rho = -.136$, $p = 0.003$).

Lidhur me planet për kohëzgjatjen e qëndrimit në migrim në vendin e destinacionit, ka rezultate të ndryshme të shqiptarëve dhe serbëve të Kosovës. Afërsisht 40 për qind e shqiptarëve të Kosovës dëshirojnë të migrojnë për një periudhë kohe mesatare prej më pak se pesë vjet. Nga ana tjetër, ata që dëshirojnë të migrojnë njëherë e mirë janë afër 35 për qind. Rreth gjysma e

serbëve të Kosovës nuk janë të sigurt mbi kohëzgjatjen e migrimit të tyre të mundshëm.

Të rinjtë që jetojnë në zonat rurale kanë një dëshirë më të fortë për të migruar për periudha më të gjata (Spearman's $\rho = -.165$, $p < 0.001$), dhe sa më të rritur të jenë të rinjtë që duan të migrojnë, aq më shumë ata dëshirojnë që të qëndrojnë në migracion (Spearman's $\rho = .177$, $p < 0.001$).

DIAGRAMI 10.7: Cili është niveli i zotërimit të gjuhës zyrtare të vendit pritës? (N=573)



ARSYET PËR TË MIGRUAR

Të anketuarit u pyetën se çfarë kishin bërë deri tani për t'u larguar nga vendi dhe arsyet për të 69 për qind e atyre që dëshirojnë të migrojnë shprehen se në lidhje me këtë ata nuk kanë bërë asgjë. Ata vetëm kanë dëshirën për të migruar, por nuk kanë ndërmarrë asnjë hap më tej. Afërsisht 20 për qind e tyre, kanë kontaktuar miq/të afërm, për t'i ndihmuar ata që të dalin jashtë vendit. Ne kemi bërë një krahasim rreth arsyeve për të migruar të viteve 2012 dhe 2018. Është e qartë se në 2018 të rinjtë e Kosovës janë të shtyrë për të migruar më shumë nga arsyet ekonomike. Arsyeja kryesore që del në 48 për qind të rasteve është pasja e një standardi më të mirë jetese jashtë vendit. Veç kësaj, pasja e mundësive më të mira të punësimit është bërë arsyeja e tretë më e rëndësishme për të migruar. Duke bashkuar këto dy arsye, ne kemi llogaritur një kombinim të "arsyeve ekonomike", të cilat janë përzgjedhur nga rreth 63 për qind e atyre që dëshirojnë të largohen nga Kosova me destinacion një vend tjetër. Ka disa korrelacione të rëndësishme statistike midis "arsyeve ekonomike" për largimin nga Kosova dhe variabëlve të tjerë. Rezultati i indeksit të pasurisë është i ndërlidhur negativisht, që do të thotë se ata që mund të konsiderohen si të "varfër" janë më të gatshëm të përmendin arsyet ekonomike për migracion (Spearman's rho=-.096, p=0.017). Gjithashtu, ata që jetojnë në zonat rurale (Spearman's rho=.099, p=0.014) dhe ata që kanë përfunduar nivele të larta arsimimi, sërish përmendin arsyet ekonomike si arsyet kryesore për migrim.


VENDET E PREFERUARA PËR TË MIGRUAR

Zvicra dhe Gjermania janë vendet e preferuara për të migruar nga kosovarët, pasi ato janë preferenca kryesore për migrim në 49 për qind të rasteve. Ekzistenca e një diaspore të madhe kosovare në Zvicër dhe Gjermani pasqyron shtrirjen e përgjigjeve të dhëna nga të anketuarit. Nga ana tjetër, ka një rritje të dukshme të preferencave për Francën, Austrinë dhe Suedinë, të cilat para gjashtë viteve nuk ishin pjesë e preferencave kryesore. Nga ana tjetër, ka një rënie të preferencave për SHBA-në dhe Anglinë, dy vende të cilat kanë qenë me preferencë të lartë në 2012. Megjithatë kosovarët vetëm në 23 për qind të rasteve e shikojnë veten si evropian, Evropa mbetet destinacioni i pa kundërshtuar favorit për qëllime migrimi.

Në vendet e sipër përmendura duhet mbajtur parasysh ekzistenca e një komuniteti relativisht të madh të diasporës kosovare. Madhësia e këtyre komuniteteve pothuajse pasqyron pjesën e përgjigjeve të marra nga të rinjtë e Kosovës.

ZOTËRIMI I GJUHËS SË VENDIT TË DESTINACIONIT

Vetëm 24 për qind e të rinjve nga Kosova që kanë dëshirë të migrojnë kanë njohuri të mira të gjuhës të punës të vendit të planifikuar si destinacionin e tyre. Kjo e dhënë tregon se të rinjtë nuk përgatiten paraprakisht rreth migrimit të ardhshëm, ose ata vetëm kanë dëshirë për të migruar, pa ndërmarrë hapa të mëtijshme për të materializuar procesin e migrimit. Nga ana tjetër, rreth 87 për qind e të rinjve kosovarë kanë dëshirë që të mësojnë gjuhën e vendeve që kanë si destinacion. Ka disa korrelacione të rëndësishme statistike midis nivelit të dijes së gjuhës së vendit si destinacion dhe variabëlve të tjerë. Rezultati i indeksit të pasurisë është i korreluar pozitivisht, që do të thotë se ata që mund të konsiderohen "të pasur" kanë shanse më të mëdha për të ditur gjuhën e vendit të destinacionit (Spearman's rho=.210, p<0.001). Nga ana tjetër, ata të cilët planifikojnë që të lëvizin në të ardhmen e afërt kanë njohuri të larta të gjuhës së vendit të destinacionit, që tregon se këta të rinj kanë kohë që përgatiten për këtë migrim të ardhshëm (Spearman's rho=-.091, p=0.051).

DIAGRAMI 10.8: **Niveli i kontributit në vendin e destinacionit**

KONTRIBUTI NË ZHVILLIMIN DHE MIRËQENIEN E VENDIT TË DESTINACIONIT

Ata që dëshirojnë të migrojnë gjithashtu tregojnë dëshirë të madhe për të kontribuar në zhvillimin dhe mirëqenien e vendit të destinacionit. Në më shumë se 90 për qind të rasteve të rinjtë nga Kosova aspirojnë që të jenë qytetarë të mirë jashtë vendit dhe të dëshmojnë performancë të lartë në punën e tyre.

Ekziston edhe një nivel i lartë prej 63 për qind i atyre të rinjve nga Kosova, të cilët do të praninin punë që nuk pranohen nga popullsia lokale. Ekzistojnë korrelacione të rëndësishme statistikore midis "pranimit të një pune më pak të dëshiruar" dhe variabëlve të tjerë. Ata të cilët pranojnë punë më pak të dëshiruara janë duke migruar kryesisht për "arsye ekonomike" (Spearman's rho=.130, p=0.003). Ata gjithashtu kanë një dëshirë të madhe për të migruar (Spearman's rho=.149, p=0.001) dhe ata dëshirojnë të migrojnë sa më shpejt që të jetë e mundur (Spearman's rho=-.211, p<0.001). Qartësisht, ata i përkasin një të pestës "më të varfër" në indeksin e pasurisë (Spearman's rho=-.129, p=0.003).

DISKUTIMI MBI MIGRIMIN

Anketimi mbi qëndrimin e të rinjve kosovarë mbi migrimin ka treguar disa rezultate të përziera. Nga njëra anë, shumica e të rinjve të Kosovës janë të kënaqur me jetën e tyre në përgjithësi, si dhe një pjesë e madhe e të anketuarve presin përmirësim të të ardhmes së tyre personale brenda 10 viteve.

Ekziston edhe një nivel i lartë prej 63 për qind e atyre të rinjve nga Kosova që do të praninin punë të cilat nuk janë të dëshiruara nga popullsia lokale. Ka disa korrelacione të rëndësishme statistikore mes "pranimit të një pune më pak të dëshiruar" dhe variabëlve të tjerë. Ata të cilat pranojnë punë më pak të preferuara. Ata të cilët pranojnë punë më pak të dëshiruara janë duke migruar kryesisht për "arsye ekonomike" (Spearman's rho=.130, p=0.003). Ata gjithashtu kanë një dëshirë të fortë për të migruar (Spearman's rho=.149, p=0.001) dhe ata dëshirojnë të migrojnë sa më herët që të jetë e mundur (Spearman's rho=-.211, p<0.001). Qartësisht, ata zakonisht i përkasin kuitiles "më të varfër" në indeksin e pasurisë (Spearman's rho=-.129, p=0.003).

Nga ana tjetër, mungesa e shpresës për të gjetur një punësim të mirë dhe përmirësim të gjendjes së tyre ekonomike janë disa nga arsytet që shtojnë rreth 47 për qind të të rinjve shqiptarë të Kosovës që të kenë një qëllim nga i moderuar deri tek të fortë për të migruar në të ardhmen e afërt. Gjithashtu, pakënaqësia me arsimin, korrupsionin, besimi i ulët tek institucionet dhe çështje të tjera kanë çuar në rritjen e ankesave dhe pakënaqësisë, duke kontribuar drejt migracionit.

Vendet e pikë synuara nga të rinjtë mbeten Zvicra dhe Gjermania, që pasqyrojnë ndikimin e diasporës së madhe kosovare në këto dy vende. Një numër i madh i të rinjve nga Kosova do të praninin punë që nuk do merreshin në konsideratë nga popullsia lokale. Përveç kësaj, motivimi për të migruar për arsye arsimore mbetet relativisht i ulët, duke krijuar një prishje ekuilibri midis dëshirës për të migruar dhe punuar në vendin e destinacionit dhe etjen për një arsim të huaj dhe më të mirë, që në vetvete mund të sjell shanse më të mira për punë në vendin e destinacionit.

11

IDENTITETI KOSOVAR, BE DHE VENDET FQINJE

Sikurse e diskutuar më sipër, besimi i të rinjve të Kosovës kundrejt institucioneve ndërkombëtare është shumë i lartë. Politika e jashtme e Kosovës ka qenë një sektor shumë i ngarkuar i Qeverisë së Kosovës, veçanërisht në përpjekjet e saj për të marrë më shumë njohje për pavarësinë e saj dhe ndërmarrë hapa të mëtejshme drejt BE-së. Pavarësisht vonesave në procesin e liberalizimit të vizave, ka një besim të lartë në Bashkimin Evropian dhe një mbështetje të fortë në lidhje me anëtarësimin në BE. Nga ana tjetër, Kosova dhe Shqipëria kanë bërë disa përpjekje për të shtuar marrëdhëniet e tyre, ndërsa njëkohësisht dialogu Kosovë – Serbi i lehtësuar nga BE, synon në normalizimin e marrëdhënieve midis Beogradit dhe Prishtinës.

GJETJET KRYESORE

- Anketa tregoi se identiteti kombëtar dhe lokal i shqiptarëve dhe turqve të Kosovës është më i fortë se sa identitetet e llojeve të tjera. Të rinjtë serbë të Kosovës duket sikur tregojnë vetëm një nivel mesatar të identitetit lokal të vendlindjes, ndërsa kryesisht refuzojnë identitetin kosovar.
- Shqiptarët dhe turqit e Kosovës në më shumë se 83 për qind të rasteve mbështesin anëtarësimin në BE. Nga ana tjetër, të rinjtë serbë të Kosovës duket sikur kanë mendime të ndara lidhur me anëtarësimin në BE.
- Ekziston një nivel i lartë optimizmi në mesin e të rinjve në Kosovë se vendi i tyre shpejt do të bëhet pjesë e Bashkimit Evropian. Më


pak se gjysma e të anketuarve (43 për qind) besojnë se kjo do jetë e mundur brenda pesë viteve të ardhshme.

- Të rinjtë e Kosovës mendojnë se Shqipëria dhe Kosova janë duke bashkëpunuar në një farë mënyre, por jo mjaftueshëm. Gjithashtu, gjysma e të rinjve kosovarë dëshirojnë që Kosova dhe Shqipëria të kenë marrëdhënie fqinjësi si shtete të pavarura, ndërsa një e treta e tyre dëshirojnë që dy vendet të bashkohen me njëra-tjetrën.
- Shqiptarët e Kosovës kanë një mendim të ndarë në lidhje me mundësinë që Serbia të njohë Kosovën. Gjysma e shqiptarëve mendojnë se Serbia do ta njohë Kosovën në të ardhmen e afërt apo të largët, ndërsa një e katërta mendon se Serbia nuk do ta njohë kurrë Kosovën.

IDENTITETI KOMBËTAR

Anketa tregoi se identiteti kombëtar dhe lokal i shqiptarëve të Kosovës dhe turqve të Kosovës është më i fortë se sa identitetet e llojeve të tjera. Të rinjtë serbë të Kosovës duket sikur tregojnë vetëm një nivel mesatar të identitetit lokal të vendlindjes, ndërsa kryesisht refuzojnë identitetin kosovar. Rreth 40 për qind e shqiptarëve të Kosovës e shohin veten e tyre tërësisht si qytetarë të botës. Për sa i përket identitetit evropian, vetëm 23 për qind e shqiptarëve të Kosovës e konsiderojnë veten si evropianë.

Ekzistojnë shumë pak indikatorë që kanë korrelacion të rëndësishëm me perceptimin për t'u konsideruar si qytetarë të botës,

DIAGRAMI 11.1: **Nivelet e identitetit të grupeve të ndryshme etnike**

ose si Evropian, ndonëse të dy deklaratat kanë një korrelacion të fortë me njëra tjetrën (Spearman's rho=.478, $p<0.001$). Meshkujt e konsiderojnë veten më shumë si qytetarë të botës (Spearman's rho=-.096, $p=0.001$), ndërsa njerëzit që jetojnë në zonat rurale kanë një preferencë të lehtë për ta konsideruar veten si Evropian (Spearman's rho=.078, $p=0.010$). Për më shumë, të rinjtë që në përgjithësi janë optimist për të ardhmen pas 10 vjetësh, gjithashtu prirën të konsiderohen si qytetarë të botës ose Evropës.

ORIENTIMI I POLITIKËS SË JASHTME


Bloku i pyetjeve që vijon analizon orientimet e politikës së jashtme për popullatën e të rinjve në Republikën e Kosovës, kryesisht, e lidhur me integrimin në Bashkimin Evropian dhe marrëdhëniet me Serbinë dhe Shqipërinë.

A DUHET KOSOVA TË BASHKOHET ME BASHKIMIN EVROPIAN?


Të rinjtë e Kosovës janë ende mbështetës të fortë të bashkimit me BE-në. Kur u pyetën nëse Kosova duhet të bashkohet me BE-në, rreth 83 për qind e shqiptarëve të Kosovës u përgjigjën "po" dhe vetëm 5 për qind e kundërshtuan atë. Një miratim i ngjashëm u gjet edhe mes turqve të Kosovës. Nga ana tjetër, opinioni i serbëve të Kosovës ishte i ndarë mes tre përgjigjeve të ngjashme. 33 për qind e tyre mendojnë se Kosova nuk duhet të bashkohet me BE-në, ndërsa 30 për qind tyre e miraton këtë lëvizje. Një pjesë tjetër prej 37 për qind nuk e dinë si t'i përgjigjen ose nuk japin përgjigje. Para gjashtë viteve, për qind ja e serbëve të Kosovës që dëshironin që Kosova të bashkohej me BE-në ishte vetëm një për qind. Sikurse pritej, të rinjtë kanë më shumë besim tek Bashkimi Evropian dhe janë më të gatshëm të mbështesin anëtarësimin në BE (Spearman's rho=-.229, $p<0.001$). Gjithashtu, sa më e pakënaqur të jetë gjenerata e re me gjendjen e demokracisë në Kosovë, aq më shumë ata shtyjnë drejt anëtarësimit në BE (Spearman's rho=-.142, $p<0.001$). Të rinjtë që jetojnë në zonat urbane (Spearman's rho=.106, $p<0.001$) dhe ata që ndjekin më pak shërbimet fetare (Spearman's rho=-.100, $p=0.001$) janë gjithashtu pak fare më shumë mbështetës për anëtarësimin në BE.

Në përgjithësi, ka një normë miratimi prej 82 për qind që Kosova të bashkohet me BE-në, një ulje shumë e vogël nga e dhëna prej 88 për qind nga i njëjti studim i vitit 2012. Kjo mbase lidhet me procesin e lodhshëm të pritjes për marrëveshjen e liberalizimit


DIAGRAMI 11.2: **A mendoni se Kosova duhet të bëhet pjesë e Bashkimit Evropian?**




DIAGRAMI 11.3: **Kur mendoni se Kosova do të bëhet pjesë e Bashkimit Evropian?**




DIAGRAMI 11.4 A: **Opinioni për mundësitë e studimit në Shqipëri?**



DIAGRAMI 11.4 B: **Opinioni për mundësitë e punësimit në Shqipëri?**



DIAGRAMI 11.5: **A mendoni se Kosova dhe Shqipëria në përgjithësi po bashkëpunojnë mjaftueshëm?**



jetë e mundur brenda pesë viteve dhe një 18 për qind shtesë parashikon ato do të hapen brenda 10 viteve të ardhshme. Ka një ndryshim të konsiderueshëm të serbëve të Kosovës në lidhje me këtë çështje. Para gjashtë viteve serbët e Kosovës ishin pothuajse tërësisht kundër bashkimit të Kosovës me BE-në, ndërsa tani në shumicën e rasteve ata nuk dëshirojnë të përgjigjen në 54 për qind të rasteve. Rreth 16 për qind e serbëve të Kosovës besojnë se Kosova do të bashkohet me BE-në në më pak se 10 vjet.

MARRËDHËNIET ME SHQIPËRINË

Më pak se gjysma e të rinjve shqiptarë të Kosovës do të studiojnë me bursa studimi në Shqipëri. Nga ana tjetër numri i serbëve të Kosovës që do të studionin në Shqipëri është shumë i ulët. Një e treta e shqiptarëve të Kosovës do të preferonin të punonin në Shqipëri, duke treguar një preferencë më të ulët në krahasim me preferencën për arsimim.

Diskutimet e grupeve të fokusit tregojnë se nuk ka dallime të mëdha mes të rinjve të Kosovës dhe Shqipërisë. Rinia e Shqipërisë shikohet si më e arsimuar në disa fusha dhe ka më shumë mundësi për shkak të liberalizimit të vizave. Pjesëmarrësit kanë mendime të përziera mbi marrëdhënien mes dy vendeve. Shumica e tyre, kryesisht pjesëmarrësit më të moshuar bien dakord që Kosova dhe Shqipëria duhet të jenë një shtet për përfitimet e lidhura me politikën dhe ekonominë. *“Ne po punojnë për t’u bashkuar me BE-në një ditë dhe së bashku jemi më të fortë. Kjo nuk ka të bëjë me nacionalizmin ose patriotizmin, ka të bëjë me arsim dhe ekonomi më të mirë. Ky është një interes madhor për të dy vendet.”* (Prishtinë, Meshkuj, 29 vjeç). Shumica e pjesëmarrësve më të rinj janë kundër bashkimit të dy vendeve dhe pak prej tyre mendojnë se ato duhet të bashkohen si një konfederatë. *“Unë nuk mendoj se kjo është një ide e mirë që të dy vendet të bashkohen. Mbase ne duhet të jemi si SHBA vende të ndryshme me të njëjtën kushtetutë.”* (Prizren, femër, 21 vjeç)


Herë pas here qeveritë e Kosovës dhe Shqipërisë organizojnë takime të përbashkëta në mënyrë që

të nxisin për bashkëpunim më të mirë. Në takime janë firmosur shumë marrëveshje, por ka shumë aktorë që ende ankohen se bashkëpunimi në letër jo përherë shoqërohet me anën praktike. Edhe të rinjtë në Kosovë, në gjysmën e përgjigjeve të tyre, e konsiderojnë se Shqipëria dhe Kosova kanë bashkëpunim të pjesshëm. Të rinjtë që jetojnë në zonat urbane janë më të prirë të përgjigjen se Kosova dhe Shqipëria nuk bashkëpunojnë mjaftueshëm (Spearman’s rho=-.063 p=0.037).

Gjysma e të rinjve kosovarë dëshirojnë që Kosova dhe Shqipëria të kenë vetëm marrëdhënie fqinjësie si shtete të pavarur, ndërsa një e treta e tyre dëshirojnë bashkimin e Shqipërisë dhe Kosovës.

Grupi i moshës më të re ka një prirje për një bashkim mes dy vendeve krahasuar kundër palën e moshës së tyre (Spearman’s rho=-.064 p=0.035). Gjithashtu, ata të cilët janë pjesë e familjeve me kushte jo të mira ekonomike janë më shumë në favor të bashkimit të dy vendeve (Spearman’s rho=-.080 p=0.008).


DIAGRAMI 11.6: **Sipas mendimit tuaj, çfarë marrëdhëniesh zyrtare duhet të kenë Kosova dhe Shqipëria?**



të vizave dhe procesit të integritimit në BE, që duket sikur po zgjasin më shumë seç pritej.


Rinia e Kosovës mbetet optimiste në lidhje me BE-në. Në përgjithësi ka një optimizëm të lartë midis të rinjve në Kosovë se vendi i tyre shumë shpejt do t’i bashkohet Bashkimit Evropian. Më pak se gjysma e të anketuarve (43 për qind) besojnë se kjo do të

DIAGRAMI 11.7: Kur mendoni se Serbia do ta njohë Kosovën?




DIAGRAMI 11.8: Opinioni mbi blerjen e mallrave serbe/kosovare

A bleni produkte të Serbisë në supermarket?



A bleni produkte të Kosovës në supermarket?



Ata të cilët konsiderohen si më fetarë mbështesin më shumë idenë e bashkimit kombëtar midis Shqipërisë dhe Kosovës (Spearman's $\rho = .065$ $p = 0.032$).

MARRËDHËNIET ME SERBINË

Çështja kryesore midis Kosovës dhe Serbisë mbetet njohja e Kosovës si një shtet i pavarur. Shqiptarët e Kosovës kanë mendime të ndara në katër pjesë për këtë çështje. Më pak se një e katërta e shqiptarëve të Kosovës mendojnë se Serbia do të njohë Kosovën brenda 5 viteve të ardhshme.

Një e katërta tjetër prej tyre shpresojnë që Serbia të njohë Kosovën në të ardhmen e largët. Një e katërta nuk besojnë se Serbia do ta njohë ndonjëherë Kosovën, ndërsa e katërta e fundit nuk ka një mendim të prerë rreth kësaj çështje.


Më pak se gjysma e të rinjve serbë të Kosovës preferojnë t'i përgjigjen kësaj pyetje. 14 për qind e tyre pranojnë mundësinë që

Serbia do të njohë Kosovën në të ardhmen, ndërsa 30 për qind e tyre nuk presin që kjo të ndodhë ndonjëherë.

Më shumë se gjysma e të rinjve serbë të Kosovës blejnë mallra serbe në supermarkete. Pak më shumë se një e treta shprehet për "aktivizimin e konsumatorit", që do të thotë shprehjen e qëndrimeve politike nëpërmjet bojkotimit të mallrave me origjinë nga Serbia. Rezultate të ngjashme tregohen edhe nga serbët e Kosovës, ndonëse një e treta e tyre nuk e dinë si të përgjigjen ose nuk japin asnjë përgjigje.

Numri i shqiptarëve të Kosovës në studim është mjaftueshëm i madh për të pasur korrelacione të rëndësishme statistikore. Sa më e vogël të jetë moshja e të rinjve, aq më të prirë janë për të refuzuar blerjen e produkteve serbe (Spearman's $\rho = -.085$ $p = 0.009$). Të rinjtë janë më optimistë për të ardhmen ekonomike të Kosovës dhe më ngurrues për të blerë produkte serbe (Spearman's $\rho = .147$ $p < 0.001$).

DIAGRAMI 11.9: **Cila nga të mëposhtmet do ta bënte komunikimin në mes nxënësve shqiptarë dhe serbë më të lehtë?**



TË MËSUARIT E GJUHËS SË GRUPIT TJETËR

Më shumë se një e treta e të rinjve shqiptarë dhe gati gjysma e të rinjve serb janë të bindur se nuk është e nevojshme që të mësohet gjuha tjetër. Nga ana tjetër kemi 29 për qind të të rinjve serb që janë dakord se të mësuarit e gjuhës së përbashkët duhet të jetë lëndë mësimore e detyrueshme për të dy komunitetet.

Gjithashtu, janë 21 për qind e të rinjve shqiptarë që mendojnë të njëjtën gjë.

Pjesëmarrësit në grupet e fokusit në përgjithësi do dëshironin që serbët që jetojnë në Kosovë të integrohen dhe të paktën duhet të flisnin shqip. *“Mua nuk më pëlqen që ata nuk flasin shqip. Në çdo vend duhet të dish gjuhën zyrtare, nëse ti jeton atje.” (Prizren, Meshkuj, 29 vjeç).*

12

PËRFUNDIME

Studimi u bazua mbi një mostër përfaqësuese prej 1000 të anketuarish, duke shtuar një kampion përforcues prej 200 të anketuarish në mënyrë që të kemi një përfaqësim më të mirë të pakicës turke dhe asaj serbe në Kosovë. Të anketuarit bien në kategorinë prej 14–29 vjeç nga e gjithë Kosova. Paketa e programit statistikor SPSS u përdor për analizën inferenciale të të dhënave.

Ky studim ka eksploruar karakterin e të rinjve që përfaqësojnë gjeneratën e pavarësisë. Të rinjtë në Kosovë janë shumë optimistë për të ardhmen e tyre dhe të ardhmen e Kosovës, por gjithashtu janë shumë pesimistë rreth gjendjes aktuale të arsimit, tregun e punës, situatën politike, etj. Zakonisht ata shprehin qëndrime konservatore që vendosin në qendër institucionin e familjes.

Familja paraqet institucionin më të rëndësishëm për të rinjtë lidhur me pothuajse të gjitha tiparet e jetës, pasi pothuajse të gjithë të anketuarit besojnë se një person ka nevojë për një familje për të pasur një jetë më të mirë. Familja ofron qëndrueshmërinë që asnjë mik, punë ose situatë politike mund të ofrojë. Nga ana tjetër, ka një rritje të rëndësishme në moshën e preferuar për martesë për burrat, në gjashtë vitet e fundit si nga meshkujt dhe nga femrat.

Tregu i punës është më pak i sigurt dhe të rinjtë në Kosovë nuk janë të aftë të gjejnë punë ku mund të përdorin dhe përmirësojnë aftësitë që kanë marrë nga sistemi arsimor. Ekziston një nevojë e madhe për fleksibilitet në punë dhe arsim për të ulur hendekun e aftësive të rinisë aktuale. Ata të cilët janë më të shqetësuar për sigurinë e punës kanë një dëshirë më të madhe të punojnë në sektorin publik dhe janë më pak të kënaqur me cilësinë e arsimit në Kosovë.

Rezultatet tregojnë se të rinjtë dëshirojnë të migrojnë për arsye ekonomike. Kosova duhet të ndërtojë themelet e saj ekonomike për të lejuar të rinjtë që të gjejnë fatin e tyre në Kosovë. Gjithashtu, kjo do të ndihmojë të rinjtë që të largohen nga prindërit e tyre dhe të kërkojnë për më shumë mundësi larg shtëpisë së prindërve.

Ekziston një mosbesim dhe apati rekord e të rinjve në Kosovë drejt të gjitha institucioneve politike, veçanërisht për partitë politike dhe qeverisjen kombëtare. Nga ana tjetër ka një besim tek institucionet fetare dhe organizatat ndërkombëtare si NATO dhe OSBE.

Gjetjet e studimit tregojnë se të rinjtë në Kosovë janë shumë të varur nga familjet e tyre. Profili i të riut në Kosovë do të jetë dikush që nuk punon në fushën e tij/saj të arsimit, por ka një dëshirë të fortë të punojë në sektorin publik. Sidoqoftë ai/ajo e di se vetëm lidhjet politike ose rrjeti familjar mund të ndihmojnë në gjetjen e punës. I riu kosovar nuk ka besim tek institucionet e Kosovës dhe shpreh një nivel të ulët angazhimi politik. Ai/ajo në përgjithësi nuk janë të kënaqur me arsimin në Kosovë, por dëshirojnë të marrin një diplomë universitare. Gjithashtu, personi mesatar ka një dëshirë të moderuar për të migruar në BE, ndonëse ata ende nuk njohin gjuhën e vendit ku ata dëshirojnë të migrojnë. Nga ana tjetër, ky i ri është shumë optimist mbi të ardhmen e tij në Kosovë dhe të ardhmen e Kosovës në përgjithësi. Personi në përgjithësi është fetar, por shumë jo tolerant kundrejt homoseksualëve. Qëllimi kryesor në jetën e tij/saj është që t'i bëjë prindërit krenar dhe të ketë një martesë të mirë. Ai/ajo do të pyes prindërit për vendimet më të rëndësishme në jetë. Moshja e preferuar për martesën e tij do të jetë 28–29 vjeç dhe e saj 25–26 vjeç. Ai/ajo preferon që të ketë tre ose më shumë fëmijë, megjithëse ai/ajo dëshiron që të ketë fëmijën e parë pas moshës 25 vjeç.

FUSNOTAT

- [1] Lavric, “Rinia në Arsim në Evropën Juglindore” Humbur në Tranzicion?.
- [2] <http://www.ks.undp.org/content/kosovo/en/home/countryinfo/>
- [3] Progresi drejt përbushjes së Kriterit Ekonomik për Pranimin në BE (Komisioni Evropian, 2018).
- [4] Termi është shpikur në Të Humbur në Tranzicion? Sfidat dhe perspektivat politike për të Rinjtë në Evropën Juglindore (2015).
- [5] Gjetjet e këtij studimi tregojnë se vetëm 13.1 përqind e të rinjve në Kosovë janë të interesuar kryesisht në ngjarjet politike që ndodhin në Kosovë (6 përqind janë shumë të interesuar, 7 përqind janë të interesuar).

REFERENCAT

- European Commission 2018 Progress Toward Meeting the *Economic Criteria for EU Accession* European Commission
- GoK 2016 *Kosovo Education Strategic Plan 2017–2021* Government of Kosovo
- GoK 2018 *Kosovo Economic Reform Programme (ERP) 2018–2020* Government of Kosovo
- 2017 *Jobs Diagnostic Kosovo* World Bank Group
- WB & WIIW 2017 *Western Balkans Labor Market Trends 2017* World Bank Group and WIIW

TABELA E DIAGRAMEVE

| | | | |
|----|---|----|---|
| 14 | DIAGRAMI 4.1: Vlerat më të rëndësishme për të rinjtë në Kosovë | 32 | DIAGRAMI 6.6: Cila nga deklaratat më poshtë e përshkruan më së miri gjendjen tuaj? |
| 14 | DIAGRAMI 4.2: Kënaqësia e të rinjve me jetesën në Kosovë | 32 | DIAGRAMI 6.7: Planifikimi familjar |
| 15 | DIAGRAMI 4.3: Përqindja e të rinjve të cilët thonë se janë shumë të kënaqur me jetën e tyre | 33 | DIAGRAMI 6.8: Sa fëmijë planifikoni ose paramendoni t'i keni? |
| 15 | DIAGRAMI 4.4: Si e shihni të ardhmen tuaj pas 10 vjetësh? | 33 | DIAGRAMI 6.9: Faktorët më të rëndësishëm për zgjedhjen e partnerit/es |
| 16 | DIAGRAMI 4.5: Opinioni i të rinjve për të ardhmen e Kosovës | 38 | DIAGRAMI 7.1: Sa jeni të kënaqur në përgjithësi me cilësinë e arsimit në vendin tuaj? |
| 16 | DIAGRAMI 4.6: Shqetësimet e të rinjve në Kosovë | 38 | DIAGRAMI 7.2: Kënaqësia me nivelin e arsimit |
| 17 | DIAGRAMI 4.7: Sjelljet që mund të justifikohen ose jo | 39 | DIAGRAMI 7.3: A pajtoheni se ka raste kur notat dhe provimet 'blihen' në institutet/universitetet në Kosovë? |
| 17 | DIAGRAMI 4.8: Deri në çfarë mase u besoni njerëzve të listuar në vijim? | 39 | DIAGRAMI 7.4: Sa orë në ditë mesatarisht i kaloni duke studiuar (pas orëve të mësimi / në shtëpi)? |
| 18 | DIAGRAMI 4.9: Si do të ndjeheshit nëse njerëz si në vijim do të vendoseshin për të jetuar në lagjen tuaj? | 40 | DIAGRAMI 7.5: Niveli i stresit në 2012 (vala 1) dhe 2018 (vala 2) |
| 18 | DIAGRAMI 4.10: Sa shpesh merrni pjesë në shërbesa fetare (përveç dasmave dhe funeraleve)? | 40 | DIAGRAMI 7.6: Pjesëmarrja në praktika |
| 19 | DIAGRAMI 4.11: Besimi fetar i etnive kryesore | 44 | DIAGRAMI 8.1: Niveli i papunësisë (mosha 15–29), në përqindjen e fuqisë punëtore |
| 19 | DIAGRAMI 4.12: Besimi fetar i prindërve dhe praktikimi i riteve fetare nga të rinjtë | 44 | DIAGRAMI 8.2: Angazhimi i të rinjve në arsim dhe punësim |
| 22 | DIAGRAMI 5.1: Aktivitetet e kohës së lirë | 45 | DIAGRAMI 8.3: Faktorët e rëndësishëm për të gjetur punë |
| 24 | DIAGRAMI 5.2: Qasja në internet | 45 | DIAGRAMI 8.4: Të rinjtë që punojnë ose jo në profesionin e tyre |
| 24 | DIAGRAMI 5.3: Arsyet kryesore për përdorimin e internetit | 46 | DIAGRAMI 8.5: Kërkesat formale për vende të punës së të rinjve |
| 24 | DIAGRAMI 5.4: Kënaqësia me pamjen fizike | 46 | DIAGRAMI 8.6: Zgjedhja e sektorit të preferuar të punës |
| 25 | DIAGRAMI 5.5: A pini duhan? | 47 | DIAGRAMI 8.7: Puna në sektorin publik: realiteti dhe preferencat |
| 25 | DIAGRAMI 5.6: A pini alkool? (N=1.000) | 47 | DIAGRAMI 8.8: Faktorët kryesorë për zgjedhjen e vendit të punës |
| 26 | DIAGRAMI 5.7: Niveli i pranimit të pirjes së alkoolit | 52 | DIAGRAMI 9.1: Interesi në ngjarjet politike |
| 27 | DIAGRAMI 5.8: Përvoja seksuale | 52 | DIAGRAMI 9.2: Interesi i të rinjve për politikën krahasuar me vitin 2012 |
| 27 | DIAGRAMI 5.9: Sjellja ndaj përdorimit të kontraktivëve | 53 | DIAGRAMI 9.3: Mosinteresimi për politikën i grupeve etnike (duke treguar përqindjet e atyre që janë "aspak të interesuar" dhe "jo të interesuar") |
| 27 | DIAGRAMI 5.10: Mendimi për virgjërinë deri në martesë | 54 | DIAGRAMI 9.4: Niveli i diskutimit të politikës me familjen dhe miqtë |
| 30 | DIAGRAMI 6.1: Sa persona jetoni në familjen tuaj, përfshirë juve? | 54 | DIAGRAMI 9.5: Ngjashmëria e pikëpamjeve politike midis të rinjve dhe prindërve |
| 30 | DIAGRAMI 6.2: Mënyra e banimit të të rinjve në Kosovë | 55 | DIAGRAMI 9.6: Përfaqësimi i interesave të të rinjve në politikat kombëtare |
| 31 | DIAGRAMI 6.3: Cila nga deklaratat më poshtë i përshkruan më së miri marrëdhëniet tuaja me prindërit? | 55 | DIAGRAMI 9.7: Burimi kryesor i informacionit për politikën |
| 31 | DIAGRAMI 6.4: A do t'i rrisnit fëmijët tuaj në të njëjtën mënyrë si ju kanë rritur prindërit juve, apo do vepronit ndryshe? | 56 | FIGURE 9.8: Votimi në zgjedhjet e kaluara |
| 32 | DIAGRAMI 6.5: Kush nga anëtarët e familjes suaj ose të afërmit ndikon më së shumti në vendimet tuaja të rëndësishme? | | |

| | |
|----|--|
| 56 | DIAGRAMI 9.9: A do të votoni nëse zgjedhjet do të mbaheshin sot? |
| 56 | DIAGRAMI 9.10: Sjelljet ndaj politikave të caktuara |
| 57 | DIAGRAMI 9.11: Kënaqësia me gjendjen e demokracisë në Kosovë |
| 57 | DIAGRAMI 9.12: Dakordësia |
| 58 | DIAGRAMI 9.13: Angazhimi në forma të ndryshme të aktivizimit |
| 59 | DIAGRAMI 9.14: Objektivat e preferuara ku duhet të fokusohet qeveria |
| 60 | DIAGRAMI 9.15: Pritjet për situatën ekonomike në të ardhmen në Kosovë |
| 60 | DIAGRAMI 9.16: Grupet që nuk kanë shumë të drejta |
| 61 | DIAGRAMI 9.17: Vlerat më të rëndësishme |
| 62 | DIAGRAMI 9.18: Besimi tek institucionet |
| 62 | DIAGRAMI 9.19: Diferencat në besimin e institucioneve në mes të rinjve shqiptarë dhe serbë |
| 66 | DIAGRAMI 10.1: Qëllimet për të studiuar jashtë shtetit |
| 66 | DIAGRAMI 10.2: Qëllimi për të emigruar për më shumë se 6 muaj |
| 67 | DIAGRAMI 10.3: Koha kur mendoni të largoheni nga vendi |
| 67 | DIAGRAMI 10.4: Kohëzgjatja e qëndrimit në shtetin e destinacionit |
| 68 | DIAGRAMI 10.5: Arsyet për të emigruar (krahasim 2012 me 2018) |
| 68 | DIAGRAMI 10.6: Shtetet e preferuara për të emigruar në 2012 dhe 2018 |
| 69 | DIAGRAMI 10.7: Cili është niveli i zotërimit të gjuhës zyrtare të vendit pritës? (N=573) |
| 70 | DIAGRAMI 10.8: Niveli i kontributit në vendin e destinacionit |
| 74 | DIAGRAMI 11.1: Nivelet e identitetit të grupeve të ndryshme etnike |
| 75 | DIAGRAMI 11.2: A mendoni se Kosova duhet të bëhet pjesë e Bashkimit Evropian? |
| 75 | DIAGRAMI 11.3: Kur mendoni se Kosova do të bëhet pjesë e Bashkimit Evropian? |
| 75 | DIAGRAMI 11.4 A: Opinionit për mundësitë e studimit në Shqipëri? |
| 75 | DIAGRAMI 11.4 B: Opinionit për mundësitë e punësimit në Shqipëri? |
| 76 | DIAGRAMI 11.5: A mendoni se Kosova dhe Shqipëria në përgjithësi po bashkëpunojnë mjaftueshëm? |
| 76 | DIAGRAMI 11.6: Sipas mendimit tuaj, çfarë marrëdhëniesh zyrtare duhet të kenë Kosova dhe Shqipëria? |
| 77 | DIAGRAMI 11.7: Kur mendoni se Serbia do ta njohë Kosovën? |
| 77 | DIAGRAMI 11.8: Opinionit mbi blerjen e mallrave serbe/kosovare |
| 78 | DIAGRAMI 11.9: Cila nga të mëposhtmet do ta bënte komunikimin në mes nxënësve shqiptarë dhe serbë më të lehtë? |

TABELA E TABELAVE

| | |
|----|--|
| 10 | TABELA 1: Shpërndarja e moshës dhe gjinisë para dhe pas matjes |
| 10 | TABELA 2: Shpërndarja e fokus grupeve |
| 23 | TABELA 3: Lidhja ndërmjet aktiviteteve të kohës së lirë |
| 32 | TABELA 4: Mosha e përshtatshme për martesë |

IMPRINT

PUBLIKOI: Friedrich-Ebert-Stiftung Kosovo

Rr. Pashko Vasa 23,
10000 Prishtinë,
Republika e Kosovës
www.fes.de/youth-studies/

PERSONI PËRGJEGJËS: Frank Hantke

KOORDINATORE PROJEKTI: Mevlyde Hyseni

KONTAKT: mevlyde.hyseni@fes-kosovo.org

REDAKTOR: Besa Kalaja, Mevlyde Hyseni

DESIGN: Andrea Schmidt • Typografie/im/Kontext

SHTYP: Studio Forma, Prishtinë, Kosovë

DATA: 2019

Qëndrimet e shprehura në publikim nuk janë domosdoshmërisht të Fondacionit “Friedrich Ebert” (FES) apo të organizatave në të cilat punojnë autorët. FES nuk mund të garantojë saktësinë e të gjitha të dhënave të përdorura në këtë publikim. Përdorimi komercial në çdo media i publikimit të Fondacionit “Friedrich Ebert” nuk është i lejuar pa miratim me shkrim të FES. Çdo referencë e bërë për Kosovën nuk paragjykon qëndrimet mbi statusin dhe është në përputhje me UNSCR (RKSKB) 1244/1999 dhe opinionin e ICJ (GJND) mbi deklarimin e pavarësisë së Kosovës. Çdo referencë e bërë për Maqedoninë nënkuptohet si referuar Ish – Republika Jugosllave e Maqedonisë.

